



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e KK Rahovec, të mbajtur më 14.11.2011, me fillim në ora 10, në sallën e KK Rahovec. Të pranishëm: Këshilltarët, kryetari dhe nënkryetari i Komunës, drejtorët e drejtorive, përfaqësuesit e MAPL, KFOR-it, OSBE-së, KDI-së, BIRK, OJQ tjera dhe mediat. Mbledhjen e ka udhëhequr z.Kujtim Popaj, kryesues dhe për mbledhjet e sotme ka propozuar këtë

REND DITE

1. Përurimi i sallës së re të Kuvendit të Komunës së Rahovecit.
2. Aprovimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara,
3. Shqyrtimi i projekt rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës ne organizata të biznesit të komunës së Rahovec-it
4. Shqyrtimi i projekt Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve investuese në territorin e komunës së Rahovec-it me numër 01-109 të datës 14.07.2006
5. Shqyrtimi i projekt vendimeve mbi shpalljen e zonave të veçanta të interesit publik.
6. Informatë rreth përgatitjes për dhënien në koncesion të Hotel Parkut.
Për sot kemi paraparë edhe disa pika të rendit të ditës pasi që këto pika kanë ardhur me urgjencë, kështu që kemi planifikuar sot me i diskutuar nëse pajtoheni ju, e ato janë:
7. Shqyrtimi i Aktvendimit për aprovimin e kërkesës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, për ndarje në shfrytëzim të ngastrës kadastrale me numër 995-2 për ndërtimin e AMF-së ne Brestovc.
8. Vendimi mbi caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit banesorë kolektiv për personat e riadhesuar.
9. Plotësimi i Komitetit për Komunitete me anëtar nga komuniteti pakicë dhe
10. Shqyrtimin e kërkesës së familjes Lushi për ndarjen e mjeteve për shërimin e Alketa Lushi-të në Itali.

1. Kryesuesi - Përfaqësuesit e USAID-it të cilët na kanë ndihmuar me pajisje të teknologjike në sallën e Kuvendit, sot nuk kanë pas mundësi të vijnë, nëse pajtoheni që këtë pikë të rendit të ditës të shtyjme për seancën e radhës, sepse pa prezencën e tyre mendoj që nuk kishte qenë e arsyeshme ta bëjmë përurimin.

E hapi diskutimin në lidhje me rendin e ditës.

Nahit Elshani: kemi bërë një kërkesë në KPF-së, që ka të bëjë me një vendim i cili është marrë ne vitin 2010 në korrik, dhe një vendim tjetër në muajin mars të këtij viti, për renovimin e zyrave për parti të politike dhe nëse ai vendim nuk respektohet dhe nuk zbatohet në praktikë, ne konsiderojmë se kryetari i komunës së Rahovecit është i pa aftë për ta ushtruar funksionin e vetë, për ti zbatuar vendimet e kuvendit komunal, të cilët e obligojnë kryetarin e komunës, në të kundërt ne do ta bojkotojmë kuvendin e komunës për aq sa kohë nuk respektohet dhe nuk zbatohen ky vendim i kuvendit të komunës dhe ne si grup i këshilltarëve të LDK-së do ta braktisim seancën.

Salih Hoti: Unë dëshiroj që t'ju bëjë me dije për një takim të cilin e kemi pasur me ftesën e zotëri Piter Faith në lidhje me Projektligjin për Hoçën e Madhe, dhe konsideroj që kanë rrëshqitur rreth deklaratës së Kuvendit të Komunës së Rahovecit, po ashtu ka ndodhur edhe një rrëshqitje rreth peticionit i cili është duke u zhvilluar në komunën e Rahovecit nga organizatat jo qeveritare lidhur po për këtë çështje. Nuk është e drejtë nga ana jonë ti mohojmë ato që i kemi aprovuar vet si Kuvend me shumicë votash pa asnjë votë kundër, ne po bijmë në lajthitje me vullnetin dhe dëshirën e qytetarëve të Komunës së Rahovecit. E imja është që këtë Kuvend të paktën ta njoftoj se çka ka ndodhur atë ditë, pavarësisht nga arsyetimi të cilën e ka bërë përfaqësuesi i zyrës ndërkombëtare, ministri i administrimit të ambientit.

Xhihad Vuçitërna: me e plotësu fjalën e zotëri Salih Hoti që tha që të gjitha parti të politike kanë marrë pjesë ne atë takim. Partia e Drejtësisë nuk ka marrë pjesë në atë takim, po na kanë ftuar sigurisht të gjithëve, vetëm njëra prej partive që ka marrë pjesë ne organizimin e peticionit ta themi prej asaj iniciativës së qytetarëve ndërsa e përkrahi fjalën e zotëri Nahit Elshani sa i përket ndarjes së zyrave për parti të politike, jam plotësisht i pajtimt në rast se Kuvendi i komunës ka marrë një vendim të tillë edhe ai duhet të zbatohet.

Rasim Fazliu: kur e dëgjova kolegun Salih u shqetësova, ne anëtar të kuvendit komunal nga PDK-ja kemi qenë në atë mbledhje, edhe në çiftë dikush tjetër ka qenë ai i bartë përgjegjësit e veta, por ne si anëtar të Kuvendit ashtu siç kemi thënë ashtu i mbrojmë qëndrimet tona, dhe qëndrojmë para atyre qëndrimeve qysh jemi marrë vesh atëherë.

Avdullah Kryeziu: çka është bërë me Ligjin për Hoçë të Madhe, me na e dhënë një informacion kryetari i Komunës ose dikush tjetër dhe rreth peticionit të nënshkruar nga qytetarët, po ashtu përforcoj diskutimin e Salih Hotit sa qytetarë e kanë nënshkruar peticionin për moszbatimin e këtij ligjit nga Kuvendi i Kosovës.

Fehim Fetoshi: më lejoni një propozim të shtimit të rendit të ditës për çështjen e ndihmës për Alketa Vehbi Lushi-gjashtë vjeçare, me 21 maj ka vdekur vëllai i Alketës, Beqa 11 vjeç. Më herët ka vdekur baba i saj Vehbiu, me vëllezërit Beqë dhe Skenderi dhe prindërit e tyre, të gjithë nga sëmundja vdekjeprurëse të pa shërueshme. Apeloj te këshilltarët që ta votojnë si pikë të rendit të ditës, dhe po ashtu edhe unë të shprehë shqetësimin tim lidhur me moszbatimin e vendimit të Kuvendit komunal në lidhje me vendimin për zyrat për partitë politike. Ai objekt është rinovuar nga buxheti komunal, ka qenë edhe një kërkesë e grupeve të këshilltarëve komunal të cilën edhe unë e kam nënshkruar që ai vendim duhet të plotësohet, përndryshe nuk ka kuptim të bëjmë punë të mëtutjeshme në këtë Kuvend.

Esad Haxhijaha: është e gjashta herë për kërkesën e të pensionuarve që në asamblenë debatohet lidhur me mundësin e kompensimeve të atyre pagave. Në mbledhjen e kaluar kemi marrë një përgjigje nga ana e kryetarit. Ata kanë qenë punëtor të Komunës, kanë dhënë një kontribut. Kërkoj t'i përgjigje apo ta vejmë në rend ditës .

Kryesuesi: gjatë kësaj jave, organizatat që janë të vendosura, një Sindikata e pensionistëve edhe dy shoqata të invalidëve, duhet të largohen prej atij objekti i cili do të kalojë në duart e partive politike.

Kryetari: ato organizata janë të vendosura aty pa ndonjë vendim apo leje me shkrim. Fjala është për Shoqatën e të verbërve, Shoqatën e pensionistëve, Sindikatën e pensionistëve dhe OFAKOS. Ne kemi gjetur zgjidhje alternative, atje ku është një shoqatë NIRVANA sepse ka mjaft zyre.

Për sa i takon çështjes së draft Ligjit apo projekt ligjit për Hoçë të Madhe, kur janë takuar udhëheqësit e partive politike me Piter Faith, ambasadorin Grek, ambasadorin Britanez, zëvendësin e përfaqësuesit të ICO-së, diplomatin Anglez Andi Sparks, Dardan Gashi, etj, edhe ne si Qeveri komunale është dashur të kishim njoftim zyrtarë se çfarë kanë biseduar me ta. Është e çuditshme që kryesuesi i Kuvendit nuk ka qenë i ftuar zyrtarisht, për sa i përket peticionit, organizator është Shoqëria civile, nuk e di cili është numri i nënshkrimeve por, kam një informatë që kanë filluar ta nënshkruajnë edhe disa serbë, që është pozitive, do me thënë edhe ata e kuptojnë që ky projekt ligji për Hoçë të Madhe nuk i ndihmon në procesin e integritetit dhe pjesëmarrjes aktive në jetën aktive dhe në jetën zhvillimore të komunës së Rahovecit. Unë e përkrahi, personalisht peticionin e shoqërisë civile, sepse jam kundër enklavizimit të Hoçës së Madhe, prandaj edhe nënshkrimi im është i pari në atë peticion.

Sot e kam në takim ministren Vlora Çitaku sërisht me ambasadorin Grekë, temë e trajtimit përveç, për riatdhesim dhe banesës kolektive, me siguri ka me qenë edhe ligji për Hoçë të Madhe. Për sa i takon çështjes së kërkesës së Alketa Lushi unë e kam përkrahur, në qoftë se do të kemi mjete unë jam për ta ndihmuar, ju mund të më ndihmoni me sa mjete ti ndihmojmë këtij rasti. Për profesorin Esat Haxhijaha shprehim keqardhje për pozitën e rëndë që e kanë pensionistët, ne nuk kemi ndonjë përgjigje sepse nuk varet nga kryetari Komunës, as nga Qeveria komunale, as nga Kuvendi komunal.

Sinan Ejupi: nuk na nevojitet një politizimit ndërmjet partive politike, takimi me Piter Faith ka qenë i thjeshtë, ka qenë informatë e drejtpërdrejtë. Të pranishëm kanë qenë të gjithë partitë politike përpos Xhihad Vuçitërnës, diskutimi ka qenë rreth zonës së shtrirjes së projektligjit në çfarë shtrirje gjeografike është, aty nuk është nënshkruar, nuk është marrë asnjë vendim. Tani këtu shesim politikë kush është më patriot. Në diskutim është kërkuar të nxirren kufijtë të shtrirjes gjeografike rreth ligjit të Hoçës së Madhe, edhe informatat shtesë. Unë besoj se të gjithë partitë politike qëndrojmë pranë atij vendimi, se ai projekt ligj është i dëmshëm, mirëpo atë projekt ligj e kemi vështirë me e ndalu.

Kryetari: Një sqarim, deklarata politike e KPF-së, dhe e Kuvendit është që të ndërpritet menjëherë procedimi i mëtutjeshëm i këtij projektligji, keni shkruar në detaje, pra bënë ligji por jo në variantin ashtu siç është.

Nahit Elshani: për zyrë për partitë politike, nuk jam i kënaqur, kemi informacion se zyrat do të jenë në objektin e komunës, e aty duhet më së paku një muaj punë për ti rinovuar zyrat, sepse janë të shkatërruara plotësisht, si subjekt politik do ti japim afat kohorë një javë ditë, deri në fund të javës përndryshe jemi këmbëngulës që vendimet e kuvendit të respektohen nga kryetari i komunës dhe nga qeveria komunale.

E dyta, absolutisht nuk ka pasur rrëshqitje nga deklarata e kuvendit e as KPF-së, më vjen keq si është shprehur kolegu Salih, ka qenë takim me përfaqësuesin special Piter Faith-in me kryetar të partive politike, aty është diskutuar për të gjetur zgjidhjen dhe janë shprehur shqetësimet nga të gjitha partitë politike lidhur me ligjin për Hoçën e Madhe. Ne jemi këshilltarë dhe nuk ju japim llogari juve për takimet që i mbajmë, pa marrë parasysh me kënd, ne jemi të lirë të takojmë edhe përfaqësuesin special edhe ministra edhe qeveritarët ndërsa ju kryetar të komunës jeni të obliguar që çdo bisedë apo takim që keni ta informoni këtë Kuvend, dhe nuk duhet të lejohen diktatet apo trysni mbi kuvendarët e kuvendit. Aty nuk ka kërkuar askush që ne të shmangemi nga deklarata, deklaratën e kemi votuar edhe qëndrojmë prapa asaj, por është biseduar që të gjinden zgjidhje dhe i kemi shprehur shqetësime tona që i kemi shpreh edhe në këtë Kuvend.

Kryetari: secili i kemi përgjegjësit e ndara edhe unë nuk të jap llogari ty z. Nahit Elshani por i jap llogari qytetarëve të komunës së Rahovec-it sepse ata më kanë zgjedh e jo ti e as ky kuvend. Me kë takoheni është çështje e juaja, mirëpo mos kërko

me kushtëzue kryetarin e komunës për realizimin e vendimeve z Nahit Elshani, këtë harroje. Fjala është për vendim për partitë politike, ne jemi përpjekur dhe ka vështirësi edhe jam shumë korrekt kur e jap një njoftim para kuvendit të komunës. Një nga zgjidhjet është BALLTAZAR-i, zgjidhja tjetër është këtu në objektin e komunës së vjetër. Ndërsa sa i takon bojkotës është çështje dhe përgjegjësi e juaja, por unë nuk do t'ju nënshkruaj mëditjet, edhe nuk i merrni pagat.

Për sa i takon ligjit për Hoçën e Madhe unë nuk pretendoj me ushtrua diktat, mirëpo ju keni nënshkruar një deklaratë politike, dhe atë ditë Piter Faithi më ka thënë jemi sqaruar me partitë politike, ai mua nuk më ka ftuar në atë takim, ai ka kërkuar që ta pres vetëm, por unë jam transparent krejt drejtorët, nënkryetari, dhe kryesuesi kanë qenë aty. Unë i kam shprehur qëndrimet e institucioneve të komunës dhe të qytetarëve të komunës përkritazi me këtë projekt ligj dhe ne kemi akoma mundësi me dhënë kontributin tonë se ky ligj nuk është i dobishëm për qytetarët e Hoçës Madhe as për qytetarët e komunës së Rahovecit, e kam njoftuar edhe për peticionin. Unë nuk i jap llogari Nahit Elshanit i jap informatat Kuvendit të komunës.

Nahit Elshani: së pari nuk ka nevojë me më dhënë llogari mua, por qytetarëve e ne jemi pjesë e tyre, ne s'jemi vetëm individ, gabon nëse mendon që ti do ti japish qytetarëve në mënyrë të drejtpërdrejt urdhëro mbaje mbledhjen në qendër more burrë.

Kryetari: Unë i kam detyra të qarta edhe ligjin e njoh mirë dhe e zbatoj me përpikëri dhe di kujt i jap llogari, i di pozicionet dhe raportet që duhet mi pas me kuvendin e komunës, që i respektoj të gjithë pa përjashtim, po uroj që ti të jesh i përgjegjshëm në ushtrimin e mandatit, edhe mos u merë me tema dytësore, ose tema që nuk kanë lidhje me kurrjë.

Kryesuesi: Këtë çështje, nuk e kemi në rend dite, ne si KK Rahovec qëndrojmë prapa deklaratave të cilat i kemi aprovuar në lidhje me projektligjin për Hoçën e Madhe. Nëse mendoni është e nevojshme për këtë çështje mund ta thërrasim një seancë. Nëse nuk kanë diçka tjetër me shtua përveç Esatit në lidhje me rendin e ditës, atëherë e qesim në aprovim.

Sali Hoti: thuhet që për çështjet patriotike është duke u diskutuar kjo, unë nuk pajtohem me këtë konstatim për shkak se, ne si Kuvend e kemi aprovuar një deklaratë të tillë. Aspekti i dytë, jam kundër këtij projekt ligji por nuk do me thënë që lëshohem në detaje çka pajtohem e çka jo, e keqja ka qenë atë ditë që takimi e ka marrë një karakter që ne nuk pajtohemi për disa çështje, përndryshe nëse korrigjohen ato çështje, bënë me projektligjin. Këtu është esenca e gabimit.

Kryesuesi: Salih, këtu nuk është vendi për me debatua në lidhje me atë çështje.

Feim Fetoshi, kolegu Salih Hoti foli dy herë për të njëjtën çështje, edhe unë kam qenë pjesë e asaj çështje e kam përfaqësuar AAK Dega në Rahovec në atë takim, dhe konsideroj që takimi ka qenë informativ dhe shumë i frytshëm, shumica e partive politike kanë qenë shumë konstruktive, në nivel të përgjegjësive të tyre, dhe të gjithë ne llogari i japim partive tona dhe një herë e përgjithmonë le të harrohet, ata që mendojnë ndryshe e kanë gabim, kjo është ideologji e së kaluarës dhe ka përfunduar një here e përgjithmonë.

Burim Krasniqi: po them që ka padrejtësi në Kuvendin komunal në Rahovec, në raport të marrjes së fjalës, po e shoh një censurë ndaj delegatëve të kuvendit komunalë, është e domosdoshme që të jetë një pikë, pyetjet dhe përgjigjet e delegatëve. kërkoj që ajo pikë të futet në rend të ditës.

Rasim Fazliu: për pikën e 7,8, dhe 9 nuk kemi material, e që është dashur me kohë me na u sigurua, në mënyrë që të kemi mundësi kurë kur është çështja me bisedua edhe ne kuvend edhe ne KPF dhe propozoj që ato të shtyhen për mbledhjen e ardhshme, ndërsa për pikën 10 pasi që është një rast humanitarë dhe me urgjencë, të shqyrtohet sot.

Esat Haxhijaha: nevoja e këtyre kërkuesve është me pas një përgjigje të asamblesë komunale. Ndërsa atë që tha kryetari është mendimi i juaj dhe i delegatëve të tjerë, atëherë ju lutem na përpiloni këtë me shkrim dhe nënshkruani këtë ju. Vet pasiviteti i delegatëve këtu rreth kësaj çështjeje mu më bënë me e kuptua kjo bie thjesht problemi i atyre pensionistëve e jo i asamblesë komunale. Kishte qenë më së miri me vë në rendë dite bile përgjigje t'ju japim që s'kemi mënyra, forma si t'ia bëjmë më tutje.

Kryesuesi: nuk e di sa është kompetencë e kuvendit me u marrë me këtë çështje unë i jap drejt kuvendit që, me diskutua, ne e qesim si pikë të rendit të ditës, mirëpo ligji i aprovuar nga kuvendi i republikës së Kosovës në lidhje me pensionistët nuk e përshkruan këtë që ju e kërkon. A pajtoheni që në seancën e radhës në mbledhjen e **KPF** –së si pikë ta qesim dhe ta diskutojmë. Në lidhje me pikën 7, 8, 9 propozimi i Rasim Fazliut në emër të grupit parlamentarë thotë që këto pika të shtyhen dhe të kalojnë në **KPF**, është interes i përgjithshëm, është kërkesë e kah motëshme, problemi ka qenë të gjendet një lokacion për ngritjen e kësaj ambulante, kjo ambulante do të ngritet duke u financuar nga një donatorë i jashtëm, është vendimi mbi caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit banesor kolektiv për personat e riatdhesuar. Pika 9 është formimi i dy komiteteve obligative, komiteti për politikë dhe financa (**KPF**) si dhe komiteti për komitete.

Kryetari: Unë e kisha ftuar edhe Rasimin edhe grupin parlamentar që vërtetë të jenë me procedurë të shpejt, po kalojmë te **AMF**-ja në Brestovc te lokacioni, po na vijnë sinjalet presion nga ana e donatorit që është **CDF**, domosdoshmërisht duhet lokacioni, drejtorja e gjeodezisë e ka gjet lokacionin, dhe mendoj që duhet me kalua, për shkak se fjala është për një donacion i cili bashkë me mjetet tona buxhetore realizon në tërësi projektin. Ne mund ta shtyjme mirëpo mund të na largohet donatori, për objektin për banesën kolektive kemi probleme me pronën, nuk kemi prona në qytet, tash e kemi gjet një pronë jashtëzakonisht të përshtatshme për nevojat e ndërtimit të banesës kolektive për personat e riatdhesuar,projekti ideor është dërguar në ministrin e integriteteve evropiane dhe për këtë çështje sot vjen ministrja Vlora Çitaku për ta debatuar çështjen e banesës kolektive,

mendoj që duhet të kaloj, kemi edhe në skicë, prona është këtu rrugës për në Brestoc, është vend i përshtatshëm sepse brenda në qytet nuk ka vend. Ndërsa, komiteti për komunitete nuk ka mundur të funksionoj, për shkak të hezitimeve të mëdha që kanë qenë në Hoçën e Madhe, tash janë emrat e propozuar mendoj që duhet të aprovohet.

Xhemajli Haxhimustafa: asnjëri prej nesh këtu nuk është kundër atyre pikave të shqyrtimit kur është në interes të përgjithshëm. Por ky kuvend po del se është kukull edhe është vetëm një makineri votash, jo makineri arsyetimi dhe gjetjes së arsyeshmërisë, ajo ndërtesë kolektive, në qoftë se e ka dhënë një specialist i ndërtimit, leje për një ndërtim atëherë do të debatohet në atë unë si laik dhe ai si specialist, nëse është komiteti për komunitete kjo kërkesë është e kamotshme. E di që ka pas kryetari vështirësi për me i gjet emrat e tyre, edhe ambulanca nuk kanë arsyeshmërinë e vetë, po mendoj e kanë peshën e vetë që mund të futet në mënyrë urgjente, shumica e votave do të vendosin dhe do të aprovohen në rend të ditës, dhe ky është qëndrim nga këto arsye jo asgjë tjetër, në afat prej 3 ditëve 5 ditëve, mund të mbajmë një mbledhje dhe ti mbajmë debate të mirëfillta në lidhje për këto pika të rendit të ditës. Ju faleminderit.

Kryetari: nuk e kemi ditur që është urgjente përcaktimi i lokacionit, kemi presion në gjetjen e lokacionit, pikërisht në këtë dhjet ditësh, nga CDF-i kemi presion në procedimin ose legalizimin e vendit ku do të ndërtohet ambulanca, sikur të ishte para dhjetë dite ne do të vendosnim në rend dite menjëherë dhe nuk do të ishte problem kjo është sikurse edhe qendra e regjistrimit civil që është dashur shpejt e shpejt me bë për shkak se ekziston rreziku me ikë ai donatori, edhe mendoj që është interes i përgjithshëm, ne lokacionin tashmë e kemi gjet, neve na vjen keq kemi mundur të lejmë për seancën e ardhshme sikur mos ta kishim këtë presion.

Te Komiteti për komunitete është biseduar me ta, disa herë kam qenë edhe në Hoçë të Madhe dhe në bashkëpunim me Sllavishën kemi arritur deri te disa emrat, të cilët mund ti përgjigjeshin detyrave që i ka komiteti për komunitete. Te çështja e lokacionit të banesës kolektive, inxhinierët kanë shkuar e kanë incizuar vendin, dhe kanë llogarit se me gjithë atë është vend më i përshtatshëm aty. Ne e kemi proceduar kërkesën në Ministrinë e integriteteve evropiane më i përshtatshëm është pikërisht ky. Kemi edhe dy variantë të tjera. Pa e gjetur lokacionin nuk mund të procedohet ma tutje, unë ju ftoj që të kaloj në procedurë të shpejt. Afati i fundit për konkurrimin e banesës kolektive ka qenë dita e premte që shkoi. Në fund ne mund ti votojmë tre lokacione, dhe ta ndërtojmë aty ku është më i miri. Mendoj që arsyetimet janë jo për qëllim me ja mbush mendjen dikujt por vërtet të gjitha këto tri pika kanë nevojë imediate që të kalohen.

Avdullah Kryeziu: herëve të tjera KPF-ja duhet ma shpejtë ti shqyrtoj e të aprovohen në kuvend, sa i përket ndërtimit të qendrës së mjekësisë familjare në fshatin Brestoc është shumë i arsyeshëm e që nuk i merr kohë kuvendit ta aprovoj sepse është interesi i qytetarëve të komunës së Rahovecit dhe regjionit. Edhe vendimi i përcaktimit të lokacionit i ndërtimit të objektit banesor është në interes të gjithë qytetarëve të komunës së Rahovec-it. Sa i përket plotësimit të komitetit për komunitete ky kuvend ka caktuar anëtarët nga kuvendi, kjo ka qenë një neglizhencë e kryetarit është dashur të funksionoj që nga fillimi, e jo tash pas tetë muajve. Shqyrtimi i kërkesës së familjes Lushi është i arsyeshëm, kërkoj mirëkuptim prej kolegëve të partive tjera politike.

Rukije Krasniqi: sa i përket pikës 9 për plotësimin e Komitetit për komunitete ai kurrë nuk ka qenë funksional për shkak të mungesës së komitetit serb edhe pse pjesëtar shqiptar dhe rom kanë qenë aktiv që nga viti 2007, 2008 e deri më sot.

Rasim Fazliu: për me i largu praktikat jo të mira, materialet me na i siguruar me kohë dhe prapë qëndrojmë para saj që pikat 7, 8, dhe 9, të mos kalojnë por vetëm pika e fundit. Çështja e ambulancës çfarë urgjence ka pas ajo, ajo ka mundur para 12 viteve të vihet e jo tash, materiali nuk mu është servuar me kohë, duhet të rrijmë 3 ditë me i kalua këto pika.

Florije Boshnjaku: unë i kam dorëzuar 3 kërkesa në CDF për ndërtimin e QMF-ve dhe AMF-ve për vitin 2012, ata kanë kërkuar pëlqimin e ministrive të cilin e kam marrë, tani thonë që pa vendim të kuvendit pa caktim të lokacionit ne nuk mund të miratojmë këtë kërkesë, nëse jeni të interesuar edhe nëse pajtoheni mirë, nëse jo atëherë e shikojmë për mbledhjet e ardhshme. Ne e kemi arsyetuar se është me ngut.

Kryesuesi: Mirë e kuptuat që janë pika me urgjencë, kush është që sot të diskutohet edhe pika 7, 8, 9, dhe 10, U aprovuan pa asnjë votë kundër dhe tri abstënime. Tani e qes komplet me të gjitha pikat të rendit të ditës në votim. Pas votimit ka konstatuar se u aprovua unanimisht rendi i ditës për mbledhjen e sotme.

2. Aprovimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara, për muajin shtator.

Rukije Krasniqi: te procesverbali i datës 12.09.2011. në faqen 9 kam cekë eliminimin e paraqitësit të pa denjë jo të pa nderë të nxënësve të shkollave tona, vetëm duhet një përmirësim, padenjë, jo të pa nderë,

Fehim Fetoshi: nuk është hera e parë që me tendencë po hiqen disa pjesë në procesverbalin. Unë kam pas një debat në lidhje për disa parregullsi në gjimnaz dhe asnjë nga këto fjalë, konsideroj që kjo është bërë me tendencë sepse aty janë folur edhe fjalë të pamatura të kryetarit të komunës, është bërë edhe demantimi i vetvetes nga drejtoresha e DKA-së. Ju lutem kolegë këshilltar komunal që ky procesverbal të mos miratohet dhe të kërkohej që të plotësohet dhe në mbledhjen tjetër kur të vjen edhe një pjesë tjetër ta miratojmë. E përsëris këtu po tentohet të spekulohet me proces verbale, të ndrydhet fjala e lirë, të bëhet presion ndaj këshilltarëve komunal. Ju lus kolegë këshilltar komunal që procesverbalin e datës 12 shtator të mos e aprovonit dhe të

kërkoni plotësimin e asaj që është hekë këtu. Unë e kam kujtesën e freskët se çka është thënë, e tëra është hekë, dhe unë prapë ju thërras të dhe ju lus që të mos votohet ky procesverbal.

Avdullah Kryeziu: kam vetëm një përmirësim të procesverbalit në faqen 15 në diskutimin tim, rreshti i dytë, procesverbali i 12 shtatorit i vitit 2011, faqe 15 rreshti i dytë, kur kam diskutuar me 15 dytit 2011 kam thënë që ekzistojnë **40 nënshkrime** e jo **14 nënshkrime** dhe kërkoj që kjo të përmirësohet.

Nahit Elshani: në faqen e dytë ku thuhet kur është aprovuar atë ditë ligji për Hoçën e Madhe do të thotë ma poshtë është, grupi i këshilltarëve propozojmë, **është** që ky ligj, do të thotë me ja shtua fjalën **është**, nuk ka kuptim vetëm ta lexoj fjalinë. Këto janë gabime teknike, gabime të vogla, nuk po them që kanë qenë me tendencë, por që po e humbin kuptimin e fjalisë. Çështja e tjetër që duhet ndryshuar është që kisha ortodokse do të thotë të shtohet fjala **është**. Faqe 5 është kah mesi diku pakoja e Ahtisarit kalojnë dhe ato janë të implementueshme pastaj **sepse** duhet me u hekë kjo, pastaj nuk na pyet kush, edhe ne fund krejt në faqen 13 do të thotë është një gabim në fund të fjalisë së parë të temës ku thotë: që i marrin edhe gratë e veta me “auto” e duhet të jetë “ato”.

Xhemajli Haxhimustafa: rastësisht edhe unë kam qenë kryesues edhe është dashur ndonjë herë ti qes ato kufjet në veshë edhe kur e kam dëgjuar vetvehten jam turpëruar se kur folsha me emocione se çfarë gabime bëjsha, procesverbali duhet ta mbaj bërthamën e diskutimit, kur është ndonjë replikë duhet të ekzistoj, stenograme i kemi të incizuara kjo do të bëhet 15-20 faqe e jo 5-6 faqe, Fahredin e di që je vetë, mundësisht të jetë sizheu i krejt diskutimit se pikërisht në lidhje me raportin për fillimin e vitit shkollor janë bërë do debate të mëdha dhe dalin do reperkusione të tjera të cilët i kemi thënë edhe në mbledhjen e 29 shtatorit, kështu që ato duhet ti përfshijmë, është me rëndësi se edhe presja ja hup kuptimin asaj.

Rasim Fazliu: Unë në faqen 13 dihet te ky procesverbal i datës 12, është te fjalimi imë aty te fjalët e mia e ka shkruar i arsimtarëve të shkollave dhe i konzervoj në **DKA** ndërsa duhet të jetë **konsideroj**.

Kryesuesi: a pajtoheni që pjesën që e ceku Fehim Fetoshi të përfshihet mirëpo ti aprovojme të dyja proces verbale.

Fehim Fetoshi: Me falë nuk mundesh ta përfshish, me u shty për mbledhjen tjetër, unë dua me pa se çka është shkruar.

Kryesuesi: Atëherë vetëm këto të 29.09. e qesim në aprovim, ndërsa të datës 12.09. e lëmë për seancën tjetër, a pajtoheni? Pasi që nuk pat vërejtje kryesuesi konstatoi se është aprovuar procesverbali i dt. 29.09.2011 pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i projekt Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit të komunës së Rahovec-it.

Musa Cena: Të gjitha vërejtje që janë dhënë në **KPF** janë përfshirë përveç matjes së gjatësisë që e ka kërkuar zotëri Fehim Fetoshi për decibela atë nuk kam mundur me e inkorporua nuk kam pas atë farë instrument edhe kërkoj falje, po mund ta leni që ajo të incizohet me decibela e pastaj të bëhet një shtesë aty, për ndryshe çdo vërejtje, sugjerim, përmirësim, janë përfshirë në versionin e ri të rregullores.

Salih Hoti: Unë e kam lexuar këtë rregullore me vëmendje për mua kontestuese është neni 8 dhe neni 9. Nuk kisha me u pajtua që restorantet, kafiteritë, ose klubet që veprojnë mbas orës 24, e këtu që parashihet deri në ora 3 të mëngjesit, unë kisha kërkuar që këtyre të mos ju lejohet të punojnë pas orës 24. Në raste të veçanta për dasma apo ahengje familjare komuna duhet të lëshoj një leje të veçantë për me vazhdua punën pas orarit të punës pas orës 12 do të thotë.

Pse po them për shkak se jemi dëshmitar të shumë punëve të ndyta që ndodhen në territorin e komunës së Rahovec-it, pikërisht tej zgjatjes së orarit të punës pas orës 12 të natës. Në këto lokale ushtrohet prostitucioni, kontrabandohet edhe droga, me një mënyrë kështu me e përmbledhë është grumbullim i kriminalitetit në territorin e Komunës së Rahovecit e **që nuk është i vogël, për shakë se jemi dëshmitarë** në media qendrore të Kosovës, jo radhë here zihen këto aktivitete të jashtëligjshme që bëhen, kështu që unë kërkoj prej delegatëve të kuvendit të komunës së Rahovecit këtë rregullore të punës, gjegjësisht lejin e vazhdimit të orarit të punës pas orës 12 ta e ndërprejnë, vetëm në rastet që e përmenda ma herët për ahengjet familjare, dasma, syneti, fejesa, etj, kështu që mendoj që ne duhet të jemi shumë të rreptë, disa qendra qysh është Xërxa, Kramoviku, me tendenca edhe disa lokalitete të tjera ne nuk duhet të jemi të mëshirshëm në këtë rast, komuna nuk ka nevojë me e rit buxhetin e vetë me puna të pista, nuk kemi nevojë për asi buxheti, qoftë edhe miliona eurosh, prandaj duhet të jemi shumë të ndërgjegjshëm edhe të përgjegjshëm, me qenë se ne kemi reagime edhe prej qytetarëve të ndryshëm lidhur me këto çështje. Unë kam vërejtje vetëm rreth këto dy pikave tjera, aspektet tjera pajtohem me këtë rregullore është në nivel. Vetëm se duhet me u zbatua. Faleminderit.

Lirih Berisha: më duket diçka absurde që orare për punë kafes bar dhe disko ju jepet gjatë gjithë ndërrimit i njëjti orar. Kisha kërkuar që orari i vikendit të jepet pak më i gjatë, mirëpo gjatë javës të jetë pakë më i shkurtër, edhe të përfundoj në ora 24, si çdo kund në vende të zhvilluara, edhe me duket pak absurde prej orës 23-05 të mëngjesit çfarë punë bëhet aty? Kërkoj që kjo të vihet në votim të bëhet një komision deri në ora 24 ndoshta të premtën mbrëma apo shtunën mbrëma, kush ka kohë do të thotë deri në ora 02-03 duhet me ja vazhdua .

Fehim Fetoshi: është fjala te Neni 8, kur për vazhdimin e orarit të punës duhet të paguhet taksa shtesë 10 euro për orë pune, kolegu Salih i përmendi e që edhe ne i kemi debatuar shumë. Por ka qenë një sugjerim nga kolegu Musa Cena, e që nga aspekti

ligjor nuk mund të eliminohet, nëse e vëmë taksën prej 100 euro për orë, kjo askujt nuk do ti leverdisë pas orës 24 nuk fitim, dhe ai është i gatshëm me pagua 100 euro për orë, atëherë automatikisht dihet që ajo aty duhet të jetë nën kontroll dhe do të jetë edhe si pikë identifikuese për policinë dhe inspektoratin, ndërsa ka ahengje familjare dhe ahengje institucionale, që kjo të jetë 10 euro. Nëse një objekt ka një vendbanim më afër se 100 metra ndalohet aktiviteti i atij lokali pas orës 24. sot kemi ndërtime dhe izolime të ndryshme objekte me izolimet sa që as 2 metra larg objektit nuk dëgjohet muzika që është brenda. sa i përket instrumenteve te matjes së zhurmave të ato nga interneti mund të bëhet download dhe çdo telefon mund ta ketë, mjafton ta aktivizosh në telefon. Nëse kjo rregullohet me ligj neve biznesit ja pamundësojmë që të zhvillojnë një aktivitet të tij edhe nëse i ka të gjitha normat e tij, thjesht në norma të standardeve evropiane, kjo është çështja sepse ka shumë e dimë se dendësi e popullsisë në Kosovë është shumë e larë, kanë njerëz që duan dhe kanë mundësi ta zhvillojnë një biznes të tillë pse ta ndalojmë me rregullore apo me ligj.

Burim Krasniqi: Faleminderit kryesues, unë kam me dhënë disa propozime pak ma konkrete, fillimisht te neni 4 periudha verore fillon me 1 Prill dhe mbaron me 30 Shtatorë, në qoftë se fillojmë me praktikën e nderimit të orës, faktikisht është java, e shtuna e fundit e muajit Tetor, faktikisht duhet me qenë diku 31 Tetor, jo 30 Shtatori, për hir që lidhen disa aktivitete bujqësore me këtë dhe ndoshta kish pas me kujua ndoshta padrejtësi në raport me bujqit. Te Neni 4 faktikisht pika A mendoj që duhet të jetë 31 Tetori e jo 31 shtatori.

Te Neni 6, pika 6.4 aty ku kërkohet zgjatja e orareve gjatë fund jave duhet të vlej njëjtë si për qytet si për fshatra si për periferi si për qendër. Te neni 12 tek tregjet unë konsideroj që duhet me pas pak konsideratë periudha verore ndoshta kishte qenë më mirë të jetë 6 deri 22 sepse është për periudhë sezoni i verës kur bujqit i shesin prodhimet vendore edhe me pas një afat kohorë pakë më të zgjatur.

Edhe propozimin e Salih Hoti- e përkrahi plotësisht për pa mundësi të vazhdimit të orarit pas orës 24 për lokale që ushtrojnë muzikë gjatë natës përveç atyre rasteve ahengjeve familjare.

Nahit Elshani te neni 8 atë nuk e di ku ka dal ky 100 euro, ne kemi kërkuar që kur është fjala për motele, restorante, dhe hotele, unë nuk jam pajtuar me 10 euro se është shumë e vogël për orë, që është fjala për ahengje familjare nuk ka shtim të orarit të punës për veprimtarit të tjera, aty ku përdoret droga, prostitucioni, dhe ku ushtrohen veprimtarit të pista, unë s'di pse ka dalë kjo këtu tash? Paguhet taks shtesë 100 euro, dhe propozoj të hiqet kjo dhe propozimi i **KPF**-së ka qenë pa këtë, oraret e punës shtohen vetëm për motele, hotele, restorante të cilat ushtrojnë veprimtari për ahengje familjare, jo për ahengje të tjera, dhe lokalet e natës,klubet e natës, nëse do zotëria me e ushtrua veprimtarinë do të regjistrohet si klub i natës, jo si restorant. ndërsa pagesa prej 10 euro është e vogël dhe duhet të ngritët.

Fehim Fetoshi: pajtohem me kolegun Nahit që nëse ju lejon ligji të mos ju zgjasim fare edhe atë 100 euro ta largojmë krejt, dhe ta largojmë fare si edhe mundësin e zgjatjes së orarit.

Kryesuesi: nëse eventualisht ndërhyjnë prej së larti atëherë duhet me e ndryshua vendimin. Për ndryshe le të mbetet pa këtë 100 euro nga ana e kuvendit, ta largojmë këtë 100 euro.

Salih Hoti: Të hiqet mundësi pas orës 24 me punua, vetëm për ahengje familjare shumë thjeshtë është kjo. Për ahengje familjare deri në ora 3 po, të tjerat jo.

Rasim Fazliu: në **KPF** jemi marrë veshë që vetëm për ahengje familjare të vazhdohet deri në ora 3 për raste të tjera deri në ora 24

Lumturije Hoti: ne kemi dashur si komitet të bëjmë ndryshim, mirëpo drejtori na dha sugjerimin se është ligji i formuluar që ata duhet të punojnë prej orës 10 e deri në ora 5 mëngjes apo prej orës 11 e deri në ora 5 në mëngjes. Ne nuk mundemi me ndryshua diçka në kundërshtim me ligjin. Ne mund të bëjmë kontroll, me bë inspektim në ato lokale, natën me polici apo në koordinim me ministrinë e inspeksionit në Prishtinë.

Musa Cena: e vetmja mos marrëveshje ka qenë qe ju i keni pas të pa përmirësuar këtë projekt rregullore ndërsa ne e patëm të përmirësuar, çdo vërejtje është përfshirë. Fehimi që e tha te decibela, në ligj shkruan 100 metra, edhe unë e kam lënë ashtu deri sa nuk kam mundur me e gjet ato decibela, një farë burim të themi informacioni me e shënua edhe kjo në kllapa, me bë një shtesë, po nuk kam mundur me e gjet, por nëse e gjej do ta vendosi, për me e kompletua.

Te veprimtarit tjera e klube nate që kanë drejt me punue në ora 11 fillojnë në ora 05 e mbarojnë. Jeta po dinamizohet. Sot keni në kryeqendër dalin të rinj në ora 12 të natës edhe rijnë gjithë netët dhe kjo farë mode mund të vie në Rahovec pas 2-3 muajve, edhe nëse ligjvënësi i ka dhënë të drejtën këtyre aktiviteteve, kush jemi ne ti parandalojmë, Prandaj nuk mundemi me ju thënë vetëm vikendeve ajo është veprimtari që regjistrohet edhe orarin e punës ai e ka të paracaktuar nuk ka nevojë që të vijë të kërkojë zgjatjen e orarit.

Pastaj si nevojë ka qenë edhe shëndetësia që krahas kujdestarisë që zhvillon shtëpia e shëndetit në Rahovec edhe një prej barnatoreve me kujdestaru në bazë të orarit të përcaktuar nga **QKMF**-ja në mënyrë që njerëzit që janë në hallë me shëndet mund të furnizohet edhe gjatë orëve të natës me këto shërbime.

Burim Krasniqi: klube të natës dhe leje edhe orari është i pa ndryshueshëm, mirëpo lejet e punës sa e di e lëshoni ju, drejtoria e juaj? Vetëm të keni kujdes, klubi i natës mundet me qenë në katin e dytë po jo me xhama të tejdukshme, dhe në qoftë se lokalet që kanë muzikë sot tentojnë të regjistrohen si klube. Kërkoj që kur lëshohen lejet pune për klube të natës të respektohen kriteret që munden me e fuqizua këtë rregullore të asamblesë komunale që po del sot.

Salih Hoti: çështja e klubeve të natës pak e kemi ngarruar prej të hënës ata fillojnë licencën e vjetër me e qit nën hije me e nxjerr një tjetër si klubet e natës edhe puno pa problem deri 05 të mëngjesit. Po ata para njëmbëdhjetëve s'kanë punë pas dymbëdhjetëve, unë kisha me thënë me e hek krejt ska punë pas dymbëdhjetëve të natës.

Musa Cena: secila veprimtari i kërkon kushtet e veta por, tash në ligj aty, që lejet e punës më të mos kërkojnë. E ka vë në hall krejt Kosovën. Edhe të gjitha komunat, po nuk kemi shpjegime se si me veprua, tash ka hi në fuqi ai plotësim duhet me marrë tash me shqyrtua se çka ka mbet tjetër që duhet ne me i kërkuar bizneseve për një lloj leje ose nuk e di edhe vetë se si me e thirr. Përndryshe këtë që Salihi e thotë ne mundemi me tërheqë komplet prej kësaj, por është ajo që ligji i ka dhënë tani ne duhet të pajtohemi me atë realitet që nuk mundemi me ju shkurtua të drejtat e veprimtarive nëse dikush regjistrohet, por pajtohem të plotësohen të gjitha ato kushte që kërkojnë për një diskotekë, për një internet, e kështu me radhë.

Salih Hoti: Kemi me qenë dëshmitarë që kjo ka me u keqpërdorë, ju faleminderit.

Musa Cena: Klubet e natës nuk janë që bëjnë muzika e zhurma, klubet e natës janë që kanë, nuk mundë t'ju sugjerojmë ne se çka duhet me marrë ata, atëherë po e propozojmë edhe po e largojmë komplet, mos u pajtoni me këto, këto Nene po i largojmë edhe po vazhdojmë.

Burim Krasniqi: Ligjet në fuqi dhe rregulloret tona nuk guxojnë të bien në kundërshtim me ligjin, mirëpo mundemi me i kushtëzua ku guxon me qenë klubet e natës. Edhe Prishtina i ka pasur po për shkak të lokacioneve, ata i kanë mbyllur. Mundemi me e nxjerr një rregullore ku i përcakton kriteret e funksionimit të klubit të natës e ne si inspektorati komunal, bashkë me policinë e Kosovës, stacioni policor në Rahovec dhe policin speciale sidomos e Rahovec-it munden me veprua në qoftë se ata devijojnë edhe pa leje pune. Mirëpo kushtet janë domosdoshmërisht me pas leje pune.

Musa Cena: E kemi një situatë që e kemi pas në Xërxe, vjen dikush e hap kazinonë edhe dëshiron me zhvillua aktivitet, ligjvënësi i ka lejuar, çka kemi me bë, ku jemi ne këtu, nuk mundemi me u nda ne prej, as që vjen ai me e marrë lejen ndoshta mbaron atje diku larg, merrni vendim çfarë mendoni se është më i mirë.

Avdullah Kryeziu: zotëri drejtor sipas informatës suaj, në Rahovec nuk kemi klub nate të regjistruar, nuk kemi, e ata janë ilegal. Nëse në Rahovec do të ketë kërkesa për klube nate, atëherë kjo të përcaktohet me një rregullore të veçantë ku do të përcaktohet orari andaj unë propozoj që me rastin kërkesës për regjistrim, marrjes së lejes, me një rregullore të veçantë të përcaktohen kushtet për dhënien e lejes për klubet e natës si dhe ngarkesa. Unë propozoj që ngarkesa të jetë 100 euro për orë, ndërsa kjo do të rregullohet me rregullore të veçantë atëherë përcaktohen kriteret me rregullore të veçantë.

Jeton Kryeziu: në komunën tonë nuk ka klube të regjistruara të natës, mirëpo zgjatje të orarit është vetëm për motele, hotele, dhe restorante, deri në orën 24, për diskoteka, bare, ligjërisht fillon orari i punës prej orës 20, mirëpo ne si kuvendi komunalë duhet të caktojmë kriteret edhe për këto klube, nuk është e drejt sikur një restorant që fillon orarin e punës në ora 7 dhe përfundon në ora 24 e atij ti vazhdohet orari i punës, prandaj unë konsideroj që shumë mirë drejtoria për ekonomi dhe zhvillim i ka cekur dhe i ka ndarë andaj unë kërkoj që ky rend dite të aprovohet dhe unë e përkrahi plotësisht me këto kushte pa atë 100 euro, sepse ai 100 euro është ngarkesë, nuk po i ngarkohet kjo klubit të natës ky 100 euro-sh, mirëpo po i ngarkohet hoteleve dhe restoranteve, sepse në fund të fundit asnjë hotel asnjë restorant nuk ka të drejt ta zhvilloj atë aktivitetin të cilin e zhvillon klubi i natës, prapë po them ne Rahovec nuk ka klub të natës e as në Xërxe nuk është e drejt, që një afarist me investua një milion euro supozojmë e tash të del dikush këtu e të thotë jo nuk ka drejt të zhvilloj ndonjë aktivitet të barit, nuk po jetojmë në vitet e 70-ta kemi jetuar pak jashtë, kemi parë, i kemi pru investimet tona, kërkoj nga drejtori i drejtorisë për ekonomi dhe zhvillim që mos ti fus krejt biznese me një thes, siç janë në Xërxe, mirëpo janë të ndara janë të regjistruara si restorante, bare, kafe, etj.

Kryesuesi: Kush është për aprovimin e kësaj rregullore? A ka kundër? Nuk ka, abstenime? Nuk ka. **Konstatohet se kjo pikë u aprovua pa vërejtje,**

4. Shqyrtimi i projekt Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve investuese në territorin e komunës së Rahovec-it. 01 nr,109 te datës 14.07.2006.

Kryesuesi - ka pasur vetëm një ndryshim te pika 8, dënimet që janë paraparë ka qenë për persona fizik prej 500-2000 euro ndërsa për persona juridik 2000-5000 euro, më duket dënimi ka qenë ma i ulët në mbledhjen e KPF-së, tash është marrë parasysh deri në 1000 ka qenë për persona fizik deri në 2000 ka qenë për persona juridik.

Ramdan Gashi: është fjala për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve investive në territorin e komunës së Rahovecit. Është pra fjala për bizneset për personat fizik dhe juridik të cilat bëjnë ndërtime në raste kur nuk ka leje ndërtimore, janë paraparë gjoba. Është ideja me i vë në rend njerëzit me leje ndërtimore të zëmë 200

persona juridik dhe persona fizikë se sa një popullatë të tërë normal që bëhen informime për ta, për një periudhë tre mujore do të informohen të gjithë për një periudhë dhe do të shkohet ma tutje.

Burim Krasniqi: unë konsideroj që ky plotësim, ky ndryshim duhet të shtyhet në seancën e radhës edhe me u shoqërua me rregulloren e vjetër edhe propozimet e reja, ashtu që delegatët në Asambleenë komunale me pas mundësi me e lexua rregulloren e vjetër me i realizua propozim ndryshimet edhe të vijnë me diskutua. Unë nuk e di çka ka pasur në rregulloren e vjetër.

Ramadan Gashi: këto farë gjobash Rregullorja e vjetër po këto farë tarifash nuk ka pasur më herët.

Kryesuesi: A ka ndryshim me rregulloren e vjetër apo është vetëm plotësimi?

Ramadan Gashi: Plotësimi është me këto tarifa, këto tarifa në rregulloren e vjetër janë. I shtohen vetëm këto pika do me thënë, vetëm plotësohet vetë titulli po të tregon.

Kryesuesi: Për derisa plotësohet me qeto faktikisht edhe ndryshohet ajo rregullore se e ka tash shtesë edhe atë material, ajo rregullore e vjetër do ta ketë edhe shtesë atë material. Nuk bëmë në kundërshtim me askënd në lidhje me këtë rregullore se kemi edhe pika të tjera të rendit të ditës.

Rasim Fazliu: Mundemi me e formulua kështu, rregullorja që ka qenë deri tash vlen po asaj i shtohen edhe këto pika, që janë të parapara .

Rustem Thaqi: zotëri drejtor e kisha një kërkesë a mundesh me na tregu me shifra sa kushton leja për ndërtimin e një shtëpie, me u pajis një person që do me e bë një shtëpi.

Ramadan Gashi: Po, për një shtëpi me dimensione 10 me 10, 200 metra katror sillet rreth 250-270 €.

Rustem Thaqi: Unë e kam një informatë ndryshe i kalon diku rreth 2000 euro.

Ramdan Gashi: Prandaj po tentoj me e bë këtë rregullore sepse gjithnjë është me u kyç me marrë leje, edhe në procedura është ndryshuar diçka kështu që këta që ndërtojnë dhe nxihen duke ndërtuar pa leje janë paraparë këto tarifa edhe thjesht është ma lehtë me i vendos gjërat në sistem.

Rustem Thaqi: Nëse është deri në 200 euro shtëpia 10 me 10 nuk është ndo një pagesë që e ngarkon edhe investitorin edhe pronarin, edhe unë jam për tu respektuar sistemi.

Kryesuesi:, nëse nuk ka dikush atëherë e qesë në aprovim këtë pikë të rendit të ditës, kush është për? A ka kundër? Abstenim? Ju faleminderit. Konstatoj që është aprovuar edhe kjo pikë e rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i projekt vendimeve mbi shpalljen e zonave të veçanta të interesit publik.

Fatmir Iska, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – janë disa zona të cilat i kemi përcaktuar dhe kjo do të vazhdojë edhe më tutje. Me këtë janë përzgjedh zonat kadastrale për Krushë të Madhe, Çifllak, Ratkoc, Senoc dhe Opterushë të cilat zona janë të interesit të veçantë publik komunal që do të shërbejnë më vonë për ndërtim të objekteve me qëllim të përmirësimit të mirëqenies të karakterit ekonomik shoqëror dhe kulturor. Nga sillajde mund t'i shihni se ku gjenden këto parcela përpos që mungon për zonën kadastrale në Krushë të Madhe objekti i ish Kooperativës. Disa nga këto zona shfrytëzohen për qëllime bujqësore nga uzurpues të ndryshëm dhe nuk janë prona kontestuese deri më tani të vërtetuara nga drejtoria jonë.

Nahit Elshani – është me interes për Komunën që këto prona të pashfrytëzuara të vihen në interes të përgjithshëm në mënyrë që në të ardhmen të planifikohen ndërtime në këto ngastra. Kam pyetje për zonën kadastrale në Ratkoc, a është ish objekti i Kooperativës dhe a është aty duke ndërtuar shtëpia e kulturës etj., ndërsa në Krushë të Madhe e di që ajo pronë është duke u shfrytëzuar prej qytetarëve të Krushës, të cilët pretendojnë që është pronë e tyre dhe a keni informacione që ata nuk e kanë fituar të drejtën për të pasur në pronësinë e vetë atë parcelë, duke ditur se gjykatat pjesën më të madhe të pronës komunale janë duke e bartur në pronësi private sipas mënyrës së tyre që kanë dhe a e dini që ato prona ende janë ashtu të uzurpuara dhe nuk kanë titullar legjitim.

Sinan Ejupi – në KPF u pajtuam unanimisht se kjo është një nismë shumë e mbarë dhe e nevojshme për marrjen e një vendimi të tillë për shpalljen e këtyre zonave me interes të veçantë publik duke ditur se Komuna e Rahovecit ka humbur shumë sipërfaqet e mëdha gjatë privatizimit posaçërisht të NBI-së. Tani është momenti i fundit që atë çka mund të shpëtojmë të marrim vendime për shpalljen e zonave të veçanta dhe ju kisha ftuar që në procedura të shkurtuara të marrim vendime për shpalljen e këtyre zonave.

Salih Hoti - sa i përket kësaj çështje është një punë që është dashur të bëhet edhe më herët me qëllim që të mos vijë deri te rrezikimi i pronës publike dhe për arsye se ne vazhdimisht po kemi mungesa të hapësirave publike e në mungesë të tyre nuk kemi mundësi të planifikojmë ndërtime për nevojat e interesit të përgjithshëm, mirëpo ajo çka është me rëndësi që këto ngastra të mos bien në duart e personave fizik të cilat për qëllimet e veta tentojnë me i tjetërsuar. Objektet ekzistuese nëse janë funksionale Komuna të bëjë mundësinë e dhënies me qira të këtyre objekteve me qëllim të rritjes të buxhetit Komunal, ndërsa ato që rrezikojnë të tjetërsohen prej AKP siç është rasti i objektit të qendrës fshatit Ratkoc që është pengesë edhe i zhvillimit të komunikacionit dhe është mirë të prishen ato dhe të planifikohet diçka tjetër, pse jo që këto prona të ruhen edhe për investim publik.

Avdullah Kryeziu – përshëndes këtë iniciativë të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër, por a është definuar prona mirë sepse siç e dimë me privatizimin e NBI përpos kapaciteteve prodhuese dhe përpunuese kanë hyrë edhe tokat bujqësore, me siguri ju e keni këqyrë këtë dhe nuk ka konteste ligjore këtu me pronarin e tanishëm Stone Castle, sepse nëse del ndonjë pengesë atëherë bie ndesh me Ligjin. Po ashtu këtu e keni futur edhe Zoqishtin e që në përshkrim nuk është, por nuk është me rëndësi, sepse edhe atje ka ekzistuar një ish Kooperativë bujqësore. Nuk e kam të qartë ngastrën kadastrale në Optrushë se ku gjendet në sipërfaqe prej 2 ari, a gjendet në rrugën kryesore apo brenda në fshat.

Lumturije Hoti – në zonën kadastrale në Krushë të Madhe te pjesa ku parashihet të shpallet interesi i përgjithshëm, ka jetuar një familje që ka deklaruar se është pronë e tyre, ndërsa unë nuk kam mundur të mbledh informacione të sakta sepse nuk e kam ditur vendin se ku gjendet dhe se ka pjesë në Krushë që nuk dihet se pronë e kujt janë, prandaj drejtori duhet të merr informacione dhe mos ka ndonjë lëndë në gjykatë.

Rukije Krasniqi – lidhur me pronën te ish Kooperativa bujqësore në Krushë të Madhe, në periferi të kësaj KB toka ka qenë private dhe kanë qenë kontestuese kurse te pjesa tjetër që parafolësja tha se personi ka banuar, aty ka qenë vetëm shfrytëzues momental deri sa ka qenë e pandërruar shtëpia për shkak të djegëjes gjatë luftës në mungesë të shtëpisë, vetëm ka qenë e përkohshme, e për pronësi të saj ende nuk ka pasur kontest në atë pjesë pronësore dhe e dimë që ajo është pronë komunale.

Esad Haxhijaha – është mirë të shihet historiku i këtyre ngastrave që të mos jenë ato të regjistruara si pronë shoqërore. Nëse kjo në Krushë ka të bëjë me parcelën e cila shërben si hapësirë për reparacion, shfrytëzimin e rërës dhe zhavorrit, atëherë nuk ka qenë e Kooperativës por e “1 Majit” dhe ajo parcelë dikur ka qenë e dhënë nga “1 Maji” në shfrytëzim me qira e tani është e uzurpuar do të thotë se mund të kemi probleme dhe konteste. Edhe mua nuk më është e qartë parcela e cila ka të bëjë me zonën kadastrale në Rahovec dhe lus drejtorin që t’na informojë se ku është kjo parcelë 91 ku thotë prona shtetërore e Kosovës, në emër të KK Rahovec ndërsa shfrytëzues Ekonomia e pyjeve. Në vitin 2002 në Kuvendin komunal kemi aprovuar një vendim për pronat e shfrytëzuara nga NBI-ja në sipërfaqe prej 870 ha dhe ne atëherë kemi parë të arsyeshëm që t’i shpallim të interesit të përgjithshëm respektivisht t’i kthehen në menaxhim Komunës. UNMIK-u na është drejtuar me një shkresë duke na falënderuar që interesohemi për asetet e pronës shoqërore por po ju informojmë se ajo është kompetencë e jona e jo e asambleve komunale dhe na vjen keq se atë vendim ju duhet me shfuqizuar, dhe kështu ka ndodhur.

Xhemali Haxhimustafa – pa një propozim nga drejtoria e caktuar në mënyrë profesionale pse shpallet interesi i përgjithshëm, cili do të jetë destinimi i mëtutjeshëm i asaj, cila është arsyeshmëria e asaj, atëherë ky vendim do të merr formën e prerë nga ky Kuvend. Ne kemi vendimin mbi shpalljen me dispozitat ligjore apo nenet e caktuara, por frikohem se do të del në fund krejt tjetër si kur tentuam që në fshatin Xërxë ish Kooperativën të bëjmë shpalljen e interesit të përgjithshëm apo ta ndalim privatizimin e saj e ku, në mënyrë taksative ka ardhur shkresa e cila është në arkivin e Kuvendit dhe AKP-ja thotë: se në kohën kur ne kemi marr informacione për privatizimin e kësaj prone nuk kemi marr kurrfarë sugjerimi se kjo është e destinuar për ndonjë destinim, dhe çdo gjë që jepet me arsyeshmëri do të zë vend në AKP dhe pas shqyrtimit japin mendimin e caktuar. Të marrim një vendim apo propozim i arsyeshëm, i cili do të ketë edhe arsyetimet se cili do të jetë destinimi, kush do të jetë përfitues nga ajo, vendimi do të jetë shumë ma legjitim .

Rustem Thaqi – Unë e përshëndes edhe drejtorin me të vërtetë për një punë bindëse, këto pamje jo vetëm që e pengojnë zhvillimin e komunës por edhe e shëmtojnë ambientin. Ky është interes i dy anshëm edhe i komunës edhe i qytetarëve të komunës sepse me të vërtetë dikush edhe mund të zhvilloj ndonjë biznes apo veprimtari të caktuar por duhet të konsultohet ligji që mos të del ndonjë mosmarrëveshje pas vendimit që e marrim ne këtu.

Një pyetje drejtorit, një objekt që është në mes të qendrës të Krushës së Madhe pronën e ka në shfrytëzim M&Silloi, a ka mundur edhe kjo të shkoj me këtë procedurë se edhe aty më duket është një sipërfaqe edhe një objekt që e shëmton qendrën e Krushës së Madhe.

Fehim Fetoshi – është një iniciativë e mirë që pasuria shtetërore të mos jetë e tjetër kujt dhe të shfrytëzohet drejt nga qytetari i komunës së Rahovec-it e të përfitoj. Ne jetojmë në një shtet të brishtë por kur ne nuk e përkrahim nga kush do të kërkojmë që të na përkrah shtetin. Paralelizma shtetëror dhe institucional ne nuk duhet të bëjmë.

Në komitet u tha nga drejtori që këto prona janë aktualisht në kompetencë të AKP-së por ata ju kanë thënë që nëse e merrni duhet ti kompensoni disi. Në këtë vendim nuk është paraparë se si do të kompensohet AKP-ja. Ne kemi interes që kjo pronë të jetë në pronësi të Rahovecit se sa të Prishtinës. Por gjithmonë në rrugë ligjore e jo kush është më i zoti ta grabit i pari. Pyes tani, çka nga momentit kur ne e marrim një vendim del një organ tjetër, AKP-ja, dhe si në rastin e kooperativës së Xërxës dhe na kthehet se një vendim i juaj është i pa fuqishëm. Në një farë mënyre ne bëmë në pozitën e injorantit të cilët votojnë për diçka që nuk dinë se pse votojnë. Drejtoria përkatëse dhe qeveria duhet të bëjnë përgatitje më të mira për këtë çështje që të mos vije deri te ndonjë konflikt institucional, komunës dhe AKP-së në mënyrë që vendimet e kuvendit komunal të jenë të plotfuqishme dhe të jenë të zbatueshme. E kam pyetur një person i cili punon në AKP, a keni pasur rast që ndonjë kuvend komunal ti shpall zonat e interesit të përgjithshëm ato që AKP-ja i ka në shfrytëzim dhe në kompetencë, përgjigja ka qenë po që kanë pasur raste por që të gjitha i kanë shpallur si jo valide, sepse është në kompetencën tonë që na e ka dhënë Parlamenti i Republikës së Kosovës.

Mendoj që edhe ne jemi pak a shumë në atë situatë po e përsëris jam absolutisht në favor që këto prona në dispozicion, dhe në kompetencë dhe në pronë të Komunës së Rahovec-it por në formë ligjore dhe të përgatitur mirë, Kam dyshime në procedurën ligjore unë do të abstenoj me votën time, është votë personale nuk flas në emër të grupit.

Fane Thaqi –e përkrahi mendimin e Xhemajlisë, e kuptoj që është në interes publik mirëpo kërkoj nga drejtori të na tregoj në mënyrë më të hollësishme arsyeshmërinë e këtyre zonave me interes të veçantë.

Kryesuesi AKM-ja është formuar shumë vonë dhe vizioni i saj ka qenë të privatizohen vetëm ndërmarrjet ose fabrikat e ish sistemit socialist, sipërfaqet e tokës nuk kanë qenë në agjendën e tyre që të privatizohen. Por erdhi deri te ajo që të privatizohen edhe sipërfaqet e tokës së ndërmarrjeve, rastin kemi në komunën tonë me privatizimin e NBI-së, ku komunës sonë ju kanë marrë 2000 hektarë tokë AKM-ja nuk na ka pyetur fare zonat janë privatizuar dhe ne nuk kemi kurrfarë qasje aty, prandaj ne kemi nevojë të shkojmë me procedura ligjore ia vlen të hyjmë edhe me gjykatë që këto prona të kalojnë në pronësi të komunës, sepse janë zona me interes ku planifikojmë të ngritet ambulanca, shkolla, çerdhe, fusha sportive, shtëpi të kulturës ose ndonjë objekt që është i interesit të veçantë për komunën e Rahovec-it.

Nëse mendoni që këto zona janë arsyeshme dhe do të na përgjigjen neve si kuvend i komunës për shfrytëzim në të ardhmen atëherë është mirë që ta votojmë edhe çështja tjetër që del me AKP-në le të jetë e kohës se çfarë zgjidhje mundë të bëjmë edhe me ata.

Nahit Elshani –unë pajtohem që është mirë me e plotësua këtë propozim, mirëpo nuk pajtohem me atë që nëse diçka është në interes të qytetarëve si prona të braktisura nga NBI-Rahoveci, Podrima, që ne mos ti lejmë ashtu edhe të presim se çka do të bëjë AKP-ja. AKP-ja nuk mund ta kontestoj një vendim që komuna e ka dhënë në shfrytëzim një pronë në interes të qytetarëve të fshatit Zoqishtë, Oterushë apo Senoc, ose Çifllak, gabimet që i kemi bërë në të kaluarën janë ndoshta këto që nuk i kemi shpallur në interes të përgjithshëm me destinim të veçantë ta paraqet aty edhe vendimin e kuvendit komunalë, arsyeshmëria se për çka është marrë në interes të përgjithshëm. Në Ratkovc dihet është shtëpia e kulturës, është ambulanca, apo çka ka njëjtë duhet të veprojë edhe me Çifllak edhe me fshatra të tjera në mënyrë që AKP-ja të mos luaj me, ka pasur kohë me i privatizua që sa vite, e jo me i lënë në këtë gjendje çfarë janë tani këto. Në Senoc është objekti i cili është në shërbim të qytetarëve është një zyre e vendit edhe mund të shpallet në interes të përgjithshme unë e përkrahi, besoj që edhe të tjerët duhet ta përkrahin këtë vendim e të mos lihen këto prona të braktisura.

Në zonën seperacioneve në Xërxë sot prej 23 hektarëve nuk e ke asnjë hektar, por të gjitha kjo gjykata jonë e famshme i ka tjetërsuar edhe tani janë pronë private. Të njoftohet gjykata të mos mundë ta bart në pronësi private të askujt por të jenë pronat që do t'ju shërbejnë interesit të përgjithshëm të qytetarëve.

Avdullah Kryeziu – Sa i përket zonës kadastrale në Senoc, këtu janë në pyetje 19 hektar e gjysmë edhe 30 hektar do të thotë bëjnë diku rreth 50 hektar, prej ku deri ku shtrihet kjo zonë, vetëm një sqarim do të doja për këtë?

Fatmir Iska drejtor i Drejtorisë për kadastrë gjeodezi dhe pronë –më tepër ishin pyetjet për prona të uzurpuara apo konteste, ai që është pronar i fundit me flet poseduese apo certifikatë ai është i zoti i shtëpisë i asaj toke, kjo është nga agjensioni kadastral i Kosovës. Prona të cilat janë marrë nga ish sistemi e janë bërë kompensime dhe prapë nëpërmjet gjykatave janë kthyer pronarët në toka të veta i ka kontrolluar dhe shfrytëzuar dy prona, edhe ato që i ka marrë ish sistemi, që ka marrë kompensim diku tjetër, edhe atë e shfrytëzon mirëpo nëpërmjet gjykatës e nxjerr edhe atë pronë që e ka pasur. Për prona të kontestuara ne mundë të ulemi me anëtarët e KPF-së të japim arsyeshmërinë më të madhe me ato projekte që mund të bëhen fusha të sportit, ambulanca, shkolla.

Tek zona kadastrale e Krushës, ajo është e M-Sillostit që është privatizuar një sipërfaqe prej 5 ari ai është pronar i fundit dhe nuk mundë të intervenojmë.

Për zonën kadastrale në Ratkovc e kemi vetëm të ndërtuara në ato parcella shtëpinë e kulturës, edhe qendrën për mjekësin familjare, në Senoc e kemi zyrën e vendit, në Çifllakë është zonë e braktisur, do me thënë që nuk u përkujdes askush i kemi disa uzurpues të cilat i shfrytëzojnë si tokë bujqësore.

Në Oterushë është kulla që figuron në emër të Podrimës edhe kjo pse mos të bartet si zonë e interesit të veçantë. Janë edhe disa zona tjera që në seancat tjera do ti shpalosim.

Salih Hoti –një plotësim për me pas një projekt konkret në secilën parcelë që dëshirojmë ta bartim në pronësi të komunës, ato objekte ekzistuese nëse është i papërshtatshëm me e rrënuar dhe me ndërtua një kamp sportiv edhe thjesht me dëshmuar që e kemi marrë për një interes të tillë. Aspekti tjetër është edhe AKP-ja nuk ka informacione për të gjitha lokacione në Kosovë edhe për të gjitha objektet që ekzistojnë. Objekt që është pengesë në zhvillimin e komunikacionit goftë në qytet brenda apo në fshatra edhe pse nuk janë pronë e jonë është mirë me i rrënuar, edhe në emër të asaj merret vendimi. Ka objekte në Xërxë në oborrin e shkollës fillore, objekt i gjelbër dy katesh , duhet të rregullohet çështja e pronësisë së tij.

Avdullah Kryeziu –pse nuk është futur edhe ish objekti i Podrimës në këtë vendim për shpalljen e zonës me interes të përgjithshëm. E keni një objekt në Oterushë të Podrimës, pse nuk është fut edhe ish objekti i Podrimës që është interes i përgjithshëm për qytetarët e komunës së Rahovecit sidomos qytetit të Rahovecit, komuna vende publike nuk ka fare në

Rahovec, nuk kemi treg, mirë kishte qenë me procedurë urgjente edhe ato me i fut si vendim të posaçëm këtu në kuvend komunal, ta shfrytëzon qyteti për nevojat e veta

Rustem Thaqi –kisha kërkuar prej juve që ta shikoni parcelën ku është shkolla fillore “Hamëz Thaqi” në Xërxe, është një parcelë në shfrytëzim të hekurudhës me sipërfaqe diku 30 ari, aty banojnë disa qytetarë herë rijnë e herë shkojnë aty vetëm të këqija për shkollë ka, nëse mund të bëhet pronë e komunës ose shkollës me interes të veçantë.

Fatmir Iska , po e përsërisë, këto janë disa nga zona kadastrale që ne i kemi përfshirë në KPF po edhe tash në kuvendin komunal, mirëpo ne jemi në rrugë e sipër për ti shpall këto zona të interesit të veçantë. Pse nuk është përfshirë, ajo do të jetë në radhën e seancave të tjera.

Ndërtesa ku po banojnë te shkolla është pronë e hekurudhës, atë e kamë vërtetuar ndërsa për pjesën tjetër unë mund të konsultohem dhe ta shikoj mundësinë se si mund të veprojmë më tutje.

Rustem Thaqi - jo vetëm ajo parcelë ka qenë aty pronë ne oborin e shkollës. Ju kanë dhënë në shfrytëzim hekurudhës atë e di se ne kemi biseduar në kryesi të fshatit, kemi planifikuar për një shtëpi të kulturës.

Kryetari –ajo që e potencoi Fatmiri unë pajtohem, ju ftoj që nëse e dini që ka prona të kësaj natyre të cilat është mirë me u shpallë zona të interesit të veçantë të na ndihmoni, ne e kemi nisur vetëm një cikël i cili ka me zgjatë, ka mjaftë prona të cilat është mirë me i shpall zona të interesit të veçantë, me i mbrojt dhe për investime publike. Prandaj vendimi i kuvendit të komunës është tepër i dobishëm edhe shumë i rëndësishëm për ecjet e mëtutjeshme në kuptimin e investimeve publike ose realizimin e projekteve publike. Më ka bërë përshtypje shkolla fillore e mesme e ulët në Sapniq është pronë e Stone Castle, vetë objekti i shkollës, oborri i shkollës, edhe mendoj që ne duhet thjesht t’ia japim kuvendit komunal, edhe mendoj që kemi me pas mirëkuptim edhe me pronarin mendoj që nuk do të ketë ndonjë telashe, po që ka mbetur në shënimet tona që është pronë e NBI-së(Stone Castel).

Rastet e tilla është mirë me i korrigjua edhe me i identifikua si pronat, ose investime ose projektet ose të objekteve të karakterit publikë siç mund të jenë shkollat AMF-të, QMF-të, shtëpitë e kulturës, qendrat sportive, fushat e sportit, etj. Puna e hekurudhës e di se është marrë në mënyrë arbitrarë, i është marrë prona shkollës në Xërxë edhe është mirë ta rikthejmë sepse është vend shumë i përshtatshëm për investim publikë.

Xhemajli Haxhimustafa - Nëqoftëse dikush mendon që AKP-ja mund të anashkalohet gabon rëndë, për arsye se është një organ vendimmarrës për pronat e Kosovës. Ne mundë të udhëheqim edhe procedurë administrative edhe procedurë korrespondence me AKP-në ku mund të vijmë deri te zgjidhja e një problemi shumë madhor, vendimi do të kalojë po neve të japim arsyeshmërinë për çdo parcelë për çka na nevojitet ju garantoj që AKP-ja s’ka me lejua 3 hektar e 74 ari me ju marrë, kurrë, po do të lejoj 5 hektar apo, 1 hektar maksimum por duke jap arsyen për çka. Jo ti përcaktojmë parcela kjo, fleta poseduese kjo, burra nuk shkon ashtu për arsye se ne kemi pasur provoj. Në kuvendin e vitit 2008 u ngritëm në mbrojtje të kooperativës në Xërxë. Askush pas asaj nuk u interesua as Xërxeja, na thanë caktojeni vendin ku ju duhet juve. Sot po del ajo shtëpia që është në oborr të shkollës, po ajo është e arsyeshme brenda natës, i thuhet AKP-së kjo është në interes të nxënësve të shkollës fillore Hamëz Thaqi do të ndërtohet fusha e sportit mirëpo kur jepet arsyeshmëria do të ketë vend edhe ky vendim.

Kryesuesi –i mbetet qeverisë në të ardhmen për secilën pronë të bie arsyeshmërinë, në të ardhmen ti shohim edhe ato zona të tjera se cilat janë në interes të përgjithshëm të komunës së Rahovec-it.

Po e qes në aprovim, kush është për aprovim? a ka kundër?S’ka. Abstenim një: Fehim Fetoshi.

6. Informata rreth përgatitjeve të dhënieve me koncesion të Hotel PARKUT.

Kryesuesi - ish HOTEL PARKU është dhënë në shfrytëzim qysh në vitin 2001 për dhjet (10) vite tani ajo kontratë ka skaduar kështu që, kam kërkuar që të kemi të gjithë dokumentacionin plotësues, në mënyrë që delegatët e kuvendit të kenë informatat më të hollësishme në lidhje me Hotel Park. Në KPF është diskutuar dhe janë formuar edhe komisionet në të kaluarën për verifikimin e investimeve, i keni aty raportet e komisioneve, gjithashtu e keni në material edhe kontratën e cila është përpiluar në atë kohë nga shfrytëzuesi i hotelit dhe kuvendi komunal, më duket që Tomphson-i ka qenë përfaqësuesi civil atëherë i komunës sonë.

Kryetari –ne kemi bërë një korrigjim përkitazi me ato vërejtje që u dhanë, thjesht e kemi rirregullua atë informatën që ka të bëjë me punën përgatitore të komisionit për përgatitjen e kushteve, kriterëve, ose standardeve, mbi bazën e të cilave do të veprohet ma tutje. Vetëm janë përmbledhë ato diskutime të cilat janë pasqyruar në debatin e KPF-së.

Nahit Elshani –më vjen mirë që janë marrë parasysh vërejtjet e tona në KPF, të cilët kanë pas të bëjnë më tepër me çështje ligjore, nuk mund të them tani që është bërë me qëllim por vazhdimi i kontratës për shfrytëzim të mëtutjeshëm të Hotel Park-ut për 1 muaj është jo ligjor që është bërë nga ana e qeverisë komunale andaj kërkoj që ky kuvend të merr sot vendim që të vazhdohet ajo kontratë për 6 muaj në mënyrë që kuvendi ti zhvillojë procedurat e mëtutjeshme si të dhënies në koncesion, apo në shfrytëzim, apo në privatizim të Hotel Park-ut. Këtu është çështja e pronës komunale. Duke marrë parasysh investimet të cilat janë bërë në atë hotel jemi që në këtë kohë prej 6 muajsh qeveria komunale respektivisht kryetari të bisedoj që, a ka mundësi kuvendi i komunal pa procedura tenderuese t’ia vazhdoi kontratën edhe për një kohë për faktin se aty vërtet janë bërë

investime më shumë se sa ka qenë e paraparë me kontratë dhe nëse po, atëherë kuvendi me ja vazhdua këtë kontratë edhe për një periudhë të caktuar për periudhën kohore që konsideron që është e mjaftueshme për qeverinë komunale për të zhvilluar procedurën edhe të konsultimeve edhe procedurat e tenderimit. Pse është vonuar qeveria të lihet një vakum institucional dhe ligjor të shfrytëzimit të këtij objekti e njëjtë do të vije çështja me objektin te Ura e Shenjtë, dhe të veprohet për të dytë. Çështja te investimet konsideroj që ajo që ka ardhur prej shfrytëzuesit aktual, për ato investime një vlerësim të bëhet nga një kompani e specializuar për këto çështje, unë konsideroj që komuna nuk ka kapacitete as njerëzore, as profesionale, as menaxheriale, që mund të bëjë një vlerësim çfarë është Hotel Park-u, se cila është vlera e këtij objekti në këtë moment.

Kryetari – pajtohem me Nahitin që jemi vonuar në përgjegjësi po që do një vëmendje të veçantë për faktin që kanë kaluar 10 vjet, dhe natyrisht ne na intereson se sa është vlera e investimeve. Ne kemi bërë një përpjekje në atë drejtim por komisioni aq sa ka punuar ka punuar, fjala është për komisionin e vlerësimit të investimeve, pajtohem që vakume institucionale nuk duhet të ketë. Mirëpo Komuna ka fuqi, ka përgjegjësi me i dhënë dy rrugëzgjdhje, negocim me pronarin aktual, negocim i një komisioni si i qeverisë, si i kuvendit, apo i përbashkët me të, lidhur me kushte dhe rrethana e vazhdimin të mëtutjeshëm apo rruga e dytë tenderimi publikë. Mund të shkojmë me propozim aktvendim, me variantin e tenderimit apo shkojmë me variantin e vazhdimin të kontratës drejtpërdrejtë. Prapë kuvendi i komunës lidhur për këtë pronë apo pronën e Urës se Shenjtë është tërësisht kompetent për me vendos a duhet me ja vazhdua kontratën apo duhet me shkua me tenderë publikë.

Nahit Elshani – Tani ti zotëri duhet t'ju thuash o mos puno o me ja qit drynin Hotel Park-ut, ose duhet me ja vazhdua ky kuvend afatin deri sa zhvillohen procedurat që ju po i përmendni, tani e ka një vazhdim të kontratës 1 muaj e që nuk është ligjore se nuk është kompetencë e drejtorit me ja vazhdua kontratën, po e këtij kuvendi komunal. Andaj është mirë që të diskutohet duke pasur parasysh investimet që i ka bërë me negociua me të për t'ia vazhduar edhe për një afat kohor shfrytëzimin e Hotel Park-ut, mirëpo jemi që të jetë kjo çështje e debatueshme me organe kompetente të nivelit qendrorë që ata e dinë më mirë a keni drejt me shkua në këtë formë apo duhet forma tjetër. Kjo duhet me bisedua thjesht me pas ne jo me marrë vendime ne këtu e nesër me e hedhë poshtë niveli qendror. Po së pari është mirë që ne me u përcaktua për sa kohë duam me ja vazhdua kontratën këtij zotërisë në këtë moment që i ka skaduar kontrata. Duhet kuvendi të merr vendim

Kryetari ja kemi vazhduar kontratën për një muaj pikërisht mos me i dhënë mundësi keqinterpretimeve ne mund të shkojmë me një variant 3 – 6 muaj të vijmë deri te një vendim legjitim, legal, edhe me normalizua qoftë vazhdimin e kontratës qoftë shpalljen e tenderit publikë e për të dyja vendos kuvendi komunal, po kuvendi komunal nuk duhet m e vendos sy mbyllurës është mirë në qoftë se ne do të kemi mundës tash. Në mbledhjen e ardhshme të KPF-së me ofrua mundësi ose informacione shtesë para se të kaloj në kuvend ne kemi biseduar edhe me kryesuesin edhe me komisionin një debat publik mund ta mbajmë për me vendos në lidhur me atë objekt prandaj 3 muaj është e arsyeshme me i dhënë, për shkak se kontratat parashikohen në atë afat kohorë.

Avdullah Kryeziu – kryetari i komunës së Rahovec-it në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ka formuar një komision në përgatitjen e kushteve për dhënien në koncesion të Hotel Park-ut, dhe kjo bie ndesh me ligjin sepse kjo është kompetencë e kuvendit. Sa i përket propozimit të zotëri Nahit Elshani ne pajtohemi sepse kemi pasur konsultime paraprake, ana ligjore thotë nëse kalon mbi 10 vite dhe nëse dëshirojmë t'ia japim dikujt për 25 – 30, 40 vite kjo kalon në kompetenca të Ministrisë së zhvillimit ekonomik ku është i formuar komision i posaçëm për vlerësimin e ligjit mbi partneritetin publiko-privat dhe koncesion, ndërsa për 10 vite është ekskluzivisht çështje e kuvendit, deri në 10 vite, mbi 10 vite nuk është çështje e kuvendit, kështu është interpretimi ligjor mirëpo, që operatorit ekonomik ekzistues ti jepet një afat kohor prej 3 – 6 muaj varet prej kuvendit ju kryetarit. Mirë është që ti jepet një afat kohorë të shqyrtohen të gjitha anët ligjore dhe pas asaj të bëhet një vendim me një kontratë dhe me ja vazhdua kontratën për 10 vite të njëjtit operator nëse jo atëherë shpallet tender publikë dhe përcaktohen kushtet dhe kriteret për dhënien me koncesion ose me partneritet publiko privat.

Kryetari - Është e drejt e kuvendit të komunës me i dhënë një pronë komunale në shfrytëzimi cilit do operatorit deri në 40 vite maksimumi është me ligj, të gjitha ato janë modalitete deri ne 40 vjet.

Burim Krasniqi – e di që funksionon një komision në kuadër të ministrisë për ekonomi dhe zhvillim dhe konsideroj që komisioni prej komunës duhet të bashkëpunoj ngushtë me atë ministri në aspektin e koncesionimit. Te komisioni për vlerësim, nuk po e mohoj investimin, nuk po dyshoj që nuk janë realizuar investimet mirëpo të jetë pak më bindëse kur është vlerësimi, faturat, dëshmitë që i kanë pasur, tek e fundit është mundësia e shikimi vizual se Hotel Parku ka qenë i hapur për komisionin gjatë gjithë kohës me u bërë vlerësimi i saj. Pajtohem me kryesuesin e LDK-së, për me i krijuar kohë dhe mundësi asamblesë me bërë një kontratë të mirëfilltë me kriteret të mira për Hotel Park-un, dhe me e favorizua pronarin për shkak që e ka një pjesë të investimeve, edhe me koncesion nuk ka mundësi me kërkua investime aq të mëdha sepse është një periudhë shumë e shkurtër kohore për me i arsyetua investimet e veta. Me e gjet formën e një afati rreth 30 vite mundësisë së koncesionimit duke konsultua njësinë për koncesionimin në ministrinë e ekonomisë dhe zhvillimit.

Kryetari Ne jemi të interesuar për modalitetin më të mirë në kushte të barabarta, edhe unë jam me e favorizua atë natyrisht në qoftë se kuvendi vendos për pa tender maksimumin me ja dhënë, edhe me pas mundësi me pa ato kriteret ma të mira të mundshme, me një yll, dy, tre, katër, etj. Sepse i mungon komunës së Rahovec-it një objekt çfarë i duhet në të ardhmen.

Rexhep Oruqi –Në fakt kemi një informatë prej komisionit të cilin e kryeson drejtori Musa Cena dhe një raport profesional i komisionit ad-hoc që e ka emëruar z. Smail Latifi kryetar i komunës. Rreth vlerësimit të investimeve mendoj se ne si kuvend as nuk kemi kapacitete profesionale sepse është çështje njerëzve të profesioneve që mund ta vlerësojnë atë me duket që operatori sado kudo ka pasur disa mbulesa me fatura çështja e investimeve është çështje e kryetarit me organet profesionale të ekzekutivit edhe ne si asamble mund të debatojmë mirëpo nuk mund të bëjmë një vlerësim as të përafërt. Sa i përket materialit të dytë që e ka bërë z.Musa Cena, ai është dashur edhe gojari me e arsyetua sepse i ka dhënë 4 opsione 4 mundësi ndër të tjera edhe shitja e hotelit që nuk e di a kemi të drejt me e shit. Po thjesht prej gjithë 13 anëtar ne mund ti caktojmë 1, 2, apo edhe 3 nga kuvendi që ti bashkëngjiten këtij komisioni, si do që të jetë, neve na duhet një profesionalizëm më adekuat z. Musa që të jetë një material më i përgatitur.

Drejtor për ekonomi dhe zhvillim **Musa Cena** –ky është një raport i shkurtër për komisionin e formuar për përgatitjen e kushteve dhe kriterëve për shpalljen e tenderit dhe mundësia e dytë kushtet nëse ky kuvend duhet të bëjë një debat në lidhje me kontratën e parë, të gjithë pajtoheni se atje ka pasur investime ose pajtoheni me i dhënë përparësi ndaj tjetrit. Komisioni i ka shqyrtuar të gjitha mundësit momentale për me e vazhdua kontratën në lidhje me atë hotel.

Tani ekziston mundësia e dhënies me qira, me koncesion, me partneritet publiko/privatë, por ta qesim edhe në shitje, dhe ky komision ka ardhur në përfundim që forma më e përshtatshme dhe më e mirë është koncesionimi, a keni kundërshtime apo keni përkrahje, a po jepni këtë 1 muaj ditë apo 2 muaj nuk është nuk bëhet ndonjë shkelje, kemi afat prej 45 ditëve e nëse shkon me vonesa siç po e shohë që po mund të shkojmë 3-6 muaj deri sa të vendoset e do ti kërkojmë që ai të krijoj kushtet që ta kategorizohet në njërin prej kategorizimeve me një .

Kryetari – Ju lutem, mos e keqpërdorni seancën e asamblesë për debate të vlerë, 10 vite as qeveria e LDK-së e as e PDK-së nuk janë marrë me këtë punë, Qeverisë komunale i intereson e sotmja dhe e ardhmja e HOTEL PARK PLAZ-ës. Përndryshe kujt i intereson e kaluara, e caktojmë seancën e veçantë këtu investitori, shfrytëzuesi hallall i qoftë që i ka bërë investime të veta i ka kryer punët e veta, shumë bukur sepse komuna në atë kohë nuk ka pasur as qeveri, as kuvend, gjatë periudhës 10 vjeçare, për zgjidhje votën e keni por megjithatë për çdo vonesë të mundshme përgjegjësin e keni direkt ju, ne ju kemi pru një informatë herën e ardhshme mund t'ju bijë propozim vendimin e qeverisë komunale si material për debat, ju atëherë e keni të drejtën me vendos për apo kundër, ne edhe kësaj radhe e kishim prua propozim vendimin mirëpo meqenëse kryesuesi ka thënë që duhet të kaloj edhe një herë në KPF ne nuk e kemi prua, përndryshe tani gati e kemi propozim vendimin që pas debatit të hidhet në votim çështja e Hotel Park Plaz-ës.

Rukije Krasniqi –në bazë të këtij raporti që e kemi nuk kemi të bëjmë fare me një kontratë sepse nuk i kanë të shkruar në librat ndërtimor asnjë organ i kuvendit komunal, asnjë organ mbikëqyrës, tjetër llogaria në investime në këtë Hotel Park nuk janë të sakta gjoja që janë kopje të dobëta, nuk po shihen qartë, do të thotë që kemi investime marramendëse në vlerë afër 2 milion euro, gjë që mund të investosh një hotel të ri bashkëkohorë. Këtij dokumenti i mungon edhe raporti i organit mbikëqyrës, edhe nënshkrimi i përfaqësuesit të UNMIK-ut të Anton Tomphson-it që do të thotë që ky zotëria nuk e ka pranuar fare si kontratë, për këto 10 vite hoteli është shfrytëzuar pa kontratë dhe sipas të dhënave kompania GASTROKOS ka dhënë dorëheqje nga shfrytëzimi tani ne nuk e dimë se kujt duhet t'ia vazhdojmë ne kontratën dhe sa ka përfituar komuna jonë gjatë këtyre 10 viteve apo kompania neve na ka vënë në borgje këtu ka përgjegjësi morale edhe politike edhe Nahit Elshani sepse ka qenë atëherë nënkryetar, askush nuk është marrë me pasurin e komunës kurë është dhënë kjo kontratë dhe a është pyetur kuvendi komunal ?

Nahit Elshani – Zonjë e nderuar, së pari ti nuk i dinë gjërat, Anton Tomphson-i e ka dhënë nënshkrimin në versionin në gjuhën angleze, nuk e nënshkruan në gjuhën shqipe dhe ato akuza mbaji për veti sepse unë nuk i frikohem akuzave.

Kryesuesi – duhet të bëjmë diçka me Hotel Park-un ju mund të jepni 1, 2 ose 3 variante ose propozimin që e dha Nahiti se nuk e njohim lëndën mirë le të vazhdoj 3-6 muaj sot që të përgatitemi ne në mbledhje të ardhshme të komitetit ku do të përgatitet komplet do t'ia propozoj kuvendit cilin variant e dëshironi, dhe kuvendi është ai i cili e miraton. Nuk hyjmë në atë që e ka paraqitur ai 1 milion e 800 mijë euro, nuk e dimë sa ka investuar i mbetet ekzekutivit është problem i kryetarit.

Kryetari – Duhet dhënë edhe një sqarim Rukijës. Ne e kemi formuar një komision për vlerësimin e investimeve, komisioni e ka pru një raport, shumë korrekt, nuk ka mundur me i vërtetua, në qoftë se ju nuk i besoni qeverisë komunale mundë të formohet edhe komisioni nga kuvendi që vështirë e ka me e vërtetue një distancë kohore 10 vjeçare .

Ne jemi gati në takimin e ardhshëm të shkojmë me propozim vendim, pas debatit në kuvend ju mund të vendosni me votën e juaj për cilin modalitet? Me respekt të kryesuesit i cili ka thënë pasi që nuk ka kaluar në KPF nuk mund të shkohet me propozim vendim përndryshe propozim vendimin keni mundur ta keni pjesë të këtij materiali nëqoftëse ju do të kërkonit pas 3 dite, a dëshironi edhe një herë në KPF me vendos propozim vendimin apo dëshironi me shkue direkt në kuvend.

Nahit Elshani – Ne duam që kryesuesi me e udhëheqë seancën si që kryesuesi duhet me pas parasysh edhe me marrë vendim këtu. Ai për mua tani është person që punon ilegalisht, ne duhet me ja vazhdua kontratën, ju nesër nëse i rregulloni këto çështje ja bëni kontratën e re. Ne kemi të bëjmë këtu me procedura.

Kryesuesi – Unë e mora parasysh propozimin e juaj prandaj pa e përfunduar të gjithë fjalimin unë nuk mundem me e vendos në votim,

Xhemajli Haxhimustafa – Nahiti e dha një propozim të pjekur edhe shumë me vend. Shumica prej nesh e dinë se ky është organ kolektiv dhe ka përgjegjësi kolektive, a do të vazhdohet kontrata edhe atë në mënyrë të përkohshme deri në kryerjen e saj mirëpo, Tomphsoni i ka pasur të gjitha ingerencat dhe e ka kryer punën e vetë. Por, operatori i cili thotë 1.800.000, edhe fëmijëve ti tregojmë në sokak nuk do na besojnë, mirëpo ka diçka reale aty dhe ka mundësi të vlerësimit. Nuk është ndërtuar ai objekt nga themeli është bërë modifikimi i sallës, është bërë modifikimi i sallës tjetër. Është një kontratë ku shkruan aty 600.000, mirëpo unë ju kisha propozuar në këtë ose në seancën tjetër ta zgjedhim problemin e investimeve të përgjithshme ku ka bërë investime, të ja zgjidhim problemin e le të punoj, të drejtën e parablerjes apo para koncesionimit mund t'ia japim si organ kolektiv që jemi për me ja lehtësua sepse ka bërë investime të parakohshme dhe nuk ka mundur ato me i materializua. Mirëpo, sa do ti jepet, për sa kohë do të nxirën ato investime, e tash Komuna e jep në koncesion atë objekt apo edhe komuna do të përfitoj diçka, pajtohem me propozimin e Nahitit, a do shkojmë 3, 4, 6 muaj me një kontratë të përkohshme për shfrytëzim, më vonë le të kryhet me ato investime 1.800.000, le të hyjmë në bisedime edhe me operatorin edhe le të nxirët një vendim i caktuar a do të shkohet në koncesion ose qysh e parasheh ligji. Nuk dëshirojmë askënd me dëmtua e posaçërisht operatorin sepse njeriu me djersë e ka fituar atë që ka investuar aty.

Kryetari – institucionet komunale nuk kanë mundur me i krye punët në raport me këtë, edhe është temë e mbyllur për mua. Qeveria formon komisione çdo kund në botë edhe një bazë për ta mbledhur këtë material, edhe këtë e kemi ofruar KPF-së edhe po i ofrojmë kuvendit. Kuvendi e ka mundësin për me vendos ne mund t'ia vazhdojmë kontratën deri sa të zgjidhet, janë, 2-3 propozime të cilat prapë vendos kuvendi edhe nuk ka nevojë me u ngatërrua me këto tema.

Komisioni për vlerësimin e saktë të investimeve është çështje e jona e nuk është e kuvendit, e kuvendit është me marrë informatë sa është vlera e investimeve, nuk jam i gatshëm me e pranua diçka që u tha këtu që komuna jonë nuk ka kapacitete. Mund të ketë kapacitete profesionale ndoshta, nuk është e lehtë me i vërtetua investimet. Në interes të komunës është një kontratë e re, një organ monitorues i cili do ta monitoroj përmbushjen e kontratës, këto janë esenciale për ne dhe mbi bazën e debateve përfundimi që nxirët në komitet të procedohet në kuvend të komunës.

NBI-së por, me shfrytëzimin nga policia federative e pastaj disa familjeve të pa strehë ai thjeshtë është

Esat Haxhijaha –hoteli në vitin 2000 ka qenë gërmadhë e cila që nga viti 1984 i është bartë në shfrytëzim shëndruar në një gërmadhë pastaj është shpallur tenderi, për renovimin e objektit i cili i ka pasur 1800 m. katror pa hapësirë rreth tij. Janë paraqitur 3-4 operator dhe kjo kompani GASTROKOS ka ofruar 600 mijë marka për ta prurë hotelin në funksion ne si bord i drejtorëve pranuan propozimin e zyrës së prokurimit që ti jepet ky hotel kësaj kompanije, ajo e ka nënshkruar kontratën si dhe Antoni Tomphsoni ,kjo kompani e ka marrë detyrën me seriozitet dhe ka filluar, zgjerimin e sallës që thjeshtë është dukur që do të jenë investime ma shumë 600 mijë marka.domethënë me rëndësi janë 600 mijë marka që janë investuar. Detyra e komunës ka qenë atëherë kur mbërrijnë fund punimet deri 600 mijë marka me e emërua një organ që e bënë pranimin teknikë. Për këta 10 vite nuk është dashur me pagua qiranë ato 600 mijë marka janë në emër të qirasë. Edhe tani unë mendojë janë të tepërta kërkesat me pa kush çka ka investuar!? Ai që ka investuar 3-4 herë më shumë se që është paraparë është njerëzore, është humanë, këtij njeriu me i dal në ndihmë që i ka bërë këto investime. Ne e kemi qenë të informuar pas 3-4 viteve nga Shkelzeni se i ka investuar diku 900 mijë euro,. Samiri vëllai i tij, e ka marrë obligimin për atë që është investuar me pranua kthime investitorit, ai jo vetëm që ka pranuar këto obligime por i ka vazhduar investimet, ka formuar disko klubin, apartamente për fjetje do të thotë se e ka investuar shumëfish ma shumë se që është dashur me investuar edhe është objekti për mrekulli me pamje moderne që e ka zbuluar rrethin aty ku është mos kishte me qenë ai, ne do ta shkathonim atë vend. Një muaj ditë kanë ardhur organet e krimit me hetua në bazë të thash e thanave, por nuk kanë gjetur asgjë. Nuk duhet të shërbehemi me fjalë të rrugëve,

Fehim Fetoshi – Kishte me qenë mirë që është çështje serioze me i thirr ata koleg kur bisedojmë të jemi pak më serioz ti kryesues është mirë me i thirr, seanca po vazhdon e po bëjnë mbledhjen jashtë, nuk është e ndershme kjo.

Mendoj që së pari të sqarohet nga ky kuvend komunal janë kompetencat e ligjin për vetëqeverisjen lokale për pronën komunale vendos kuvendi komunalë, me propozimet dhe sugjerimet e qeverisë, e para, e dyta, kontrata, kjo kontratë e cila është shënuar në lë shumë për të dyshuar. Por unë mendojë që është neni 6 i cili është shumë i qartë. Edhe më lejoni ta lexoj. Marrësi garanton se e ka inspektuar objektin e Hotel Parkut dhe e pranon atë si objekt në gjendje si është dhe për renovimin dhe funksionalizimin e tij do të investoj së paku 600 mijë marka. Unë mendoj se marrësi e ka marrë Hotel Parkun si gërmadhë dhe ka pranuar të investoj për funksionalizimin e tij të paktën 600 mijë marka. Mendoj që ne së paku në këtë pikë pajtohemi së paku 300 mijë euro pra 600 mijë marka janë investuar, dhe nuk e di se çka bisedojmë ma tutje, kjo është shumë e qartë. Tani,

shfrytëzuesi aktual pretendon që ka investuar një shumë më të madhe, mendoj që kuvendi komunal nuk duhet me u marrë me këtë çështje, nëse shfrytëzuesi aktual pretendon që është i dëmtuar nga koha në raport me investimet që ka bërë, ai mund ti drejtohet me një padi gjykatës, komunës apo atij që ka bërë dhe ta shtrojë këtë çështje. Për kuvendin komunal është me rëndësi këto 600 mijë marka nuk kontestohen nga askush, dhe ne nuk kemi nevojë të humbim kohë në këtë pikë. Komisioni e ka kryer punën e vetë mirëpo atij i ka pushuar mandati në momentin kur ai e ka dhënë një vlerësim. Ky zotëri i cili tani e administron hotelin më së paku meriton që të jetë ilegal qoftë edhe një orë në atë hotel. Është me vend propozimi i kolegut Nahit që ky Kuvend t'ia jep autorizimin kryetarit të komunës që t'ia bëjë një kontratë të përkohshme deri në përfundimin e çështjes. Dy çështje janë shumë karakteristike për këtë hotel. Është i vetmi hotel në qytetin e Rahovec-it dhe tjetra është e vetmja mundësi për të pasur një hotel në qytetin e Rahovec-it. Edhe ndonjë milioner apo miliarder nëse vjen në Rahovec, nuk ka mundësi ta ndërtoj një hotel tjetër sepse nuk ka vend. Besoj që edhe vetë shfrytëzuesi aktual nuk është i kënaqur me kualitetin e shërbimit që ofron hoteli. Dhe si për përfundim kryetari i Komunës tha e ka gati propozim vendimin, kishte qenë mirë me u konsultua qoftë këtë me bë edhe me Komitet edhe me grupet e këshilltarëve komunal, dhe para se të vije një vendim në Kuvend mendoj se ai vendim duhet të jetë i përgatitur mirë edhe kishte me qenë mirë të jetë së paku për afërsisht i harmonizuar me grupe politike që janë të përfaqësuar në kuvend komunal. Pra si përfundim apeloj që kjo pikë të mos mbyllet pa legjitimuar shfrytëzuesin aktual.

Sinan Ejupi –është mirë që shfrytëzuesit momental të hotelit ti jepet një afat i caktuar deri në zgjidhjen përfundimtare pa caktimin e datave, kohës, muajve, deri në zgjidhjen përfundimtare edhe të ftoni një seancë të KPF- dhe t'i zgjidhim problemet të cilat janë të grumbulluara dhe të mos lejojmë nga 10 pika në rend dite. Atëherë këto 3 pika të ardhshme bashkë me vendimin i cili do të vije në seancën e ardhshme të KPF-së rreth çështjes së hotelit ta diskutojmë së bashku dhe plotësisht pajtohem rreth kushteve të caktuara të cilët duhet t'i vendoset shfrytëzuesit të ardhshëm.

Rasim Fazliu –unë pajtohem me shumicën e mendimeve që u dhanë, por mendoj se në kontratën e 2001 askund nuk shkruan sa sipërfaqe ka të brendshme dhe të jashtme hoteli, për të ardhmen është mirë me u ditë saktësisht sipërfaqja .

Kryesuesi –që të mos punoj në mënyrë ilegale operatori i cili e ka në shfrytëzim hotelin atëherë t'ia vazhdojmë në një periudhë 6 muaj, kryetari me e prue aktvendimin ne do ta shqyrtojmë në kuvend, në të ardhmen ti hulumtoni edhe ligjet, dhe ai i cili i ka idetë me të përafërta dhe më të sakta le ti paraqesë kur do që është e nevojshme do t'iu thërrasim nëse dëshironi në seancë, nëse dëshironi ju thërrasim kryetarët e grupeve parlamentare dhe i jepni variantet. Atëherë kush është për vazhdimin e kontratës operatorit deri në 6 muaj? Faleminderit, a ka kundër? Nuk ka, abstenim? Nuk ka. Faleminderit.

7. Shqyrtimi i aktvendimit për aprovimin e kërkesës së drejtorisë së shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, për ndarje në shfrytëzim të ngastrës kadastrale me numër 995-2 për ndërtimin e AMF-së në Brestovc.

Flori Boshnjaku, drejtoreshë e Drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale – prej 3 projekteve kapitale në vitin 2012: ndërtimi i institucioneve shëndetësore në Xërxë, në Brestovc edhe në lagjen e epërme, në CDF për donacione vetëm njëri ka kaluar, ndërtimi i ambulancës të mjekësisë familjare në fshatin Brestovc. Gjatë konsultimit me CDF-in ata kanë kërkuar të merret pëlqimi së pari prej ministrisë së shëndetësisë. Në ministrinë e shëndetësisë janë pajtuar që të ndërtohet ambulanca e mjekësisë familjare në fshatin Brestovc. CDF-i kërkon edhe pëlqimin e kuvendit komunal për shpallje në interes të përgjithshëm për ndërtimin e kësaj AMF-je, prandaj edhe kërkoj që të keni një mirëkuptim dhe që kjo pikë të kalon për shkak se kemi një donacion nga banka botërore për ndërtimin e këtij objekti shëndetësor. Drejtorja për gjeodezi ka dal në vend, dhe e ka caktuar lokacionin 10 ari truall është kemi qenë në bashkëpunim me zotëri Nahit Elshanin vendin e kemi caktuar.

Feim Fetoshi – kërkoj nga Nahiti apo Marigona që të na tregoj që a është edhe popullata, komuniteti i pajtimt për lokacionin që drejtorja e ka propozuar dhe besoj që çdo gjë do të jetë e qartë.

Nahit Elshani – ne jemi dakorduar me fshatin Hoçë e Vogël, nëse zyra e vendit do të bëhet në Hoçë, ambulanca do të bëhet në Brestovc për shkak se nuk kemi vend në mes të dy fshatrave, prej vitit 2000 jemi munduar që të blejmë pronë në mes të dy fshatrave që ta bëjmë edhe zyrën e vendit edhe ambulancën mirëpo nuk kemi mundur të gjejmë. Është vendosur për Brestovc se edhe në master planin e ministrisë ekziston ambulanca në fshatin Brestovc bile ata kanë kërkuar që të bëhet edhe renovimi i asaj ambulance, mirëpo nuk mund të rinovohet sepse është e shkatërruar plotësisht nga lufta, ekspertët komunal e kanë bërë vlerësimin se aty nuk mund të bëhet renovimi i asaj ambulance mirëpo duhet të ndërtohet një e re. Vendi është i përshtatshëm për skaj të rrugës, hapësirë mjaftë e madhe prej 10 ari, konsideroj që i plotëson të gjitha kushtet dhe është funksionale edhe për Hoçën edhe Brestoc.

Kryesuesi – e qes në votim, kush është për aprovimin e kësaj? Faleminderit , a ka kundër? Nuk ka, abstenime? Nuk ka.

8. Vendimi mbi caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit banesorë kolektiv për personat e riatdhesuar.

Fatmir Iska drejtor për gjeodezi –është një donacion prej zyrës ndërlidhëse të Komisionit evropian në kuadër të Ministrisë së integriteteve. Lokacionin e kemi ndarë tek udhëkryqi, rruga për në Brestovc diku rreth 50 metra e kemi edhe në fotografi në skicë të planit por edhe në certifikatë, 11 ari. Inxhinierët e komunës kanë propozuar që aty të bëhet ajo ndërtesë e banimit

kolektiv për personat e riadhesuar d.m.th. të kthyer pas lufte, kemi zotime nga ministresha e integriteteve që sot e kemi pasur mysafire në komunën tonë.

Esat Haxhijaha – Sa banesa janë në pyetje, çfarë është dimensione ka edhe a ka hapësirë për parking ? ai vend është pak si i pjerrtë pak si i ngushtë shumë.

Fatmir Iska drejtor për gjeodezi - 11 ari është vend i mjaftueshëm edhe për parking, 30 është në certifikatë do të thotë aty përfshihet edhe rruga që e përdor Hashim Miftari po edhe shumë të tjerë, për atë arsye edhe del në certifikatë 30 ari, ekspert e kanë vlerësuar se mund të ndërtohet ajo banesë kolektive deri në 12 banesa e mund të bëhen edhe më shumë.

Sinan Ejupi –është problem se ky vend është i mbushur, ne kur flasim eksperta do me thënë investimi si investim nuk do koment është i mirëseardhur, sa është i sigurt ai vend, ai është i mbushur aty, është mjaftë i rrezikshëm.

Fehim Fetoshi –ne si kuvend komunal nuk duhet të lëmë çështjet në duar të inxhinierëve, por kolegu Xhemali e tha në fillim që është pak problem tash e tregoj edhe Sinani. Këta kanë jetuar dhe e dinë atë vend rrezikshmërinë e ne si kuvend komunal nuk duhet të përdoremi si mekanizëm vote, drejtori është dashur që të dal me një propozim të inxhinierëve me gjithë se e kanë ditur që ai vend është i mbushur a është bërë ndonjë analizë statistike apo gjeologjike. Nuk është mirë të votojmë t'iu lëmë ekspertëve dhe në fund të na ndodhin avaritë.

Kryetari – sot për terrenet e mbushura ka zgjidhje plotë. Është edhe rekomandimi i komisionit, prona është shumë e përshtatshme nuk do të thotë që duhet me u lënë pasi është e shkretë. Janë çështjet të cilat duhet të kalojnë sepse lokacioni është shumë të përshtatshëm dhe se nuk ka ndonjë lokacion të tillë në qytet.

Burim Krasniqi –Toka e butë ose e mbushur vetëm mund të kushtoj më shtrenjtë në koston e investimeve, mirëpo në qoftë se bëhet me analiza gjeoteknike nuk ka mundësi me ndodh diçka.

Xhemajli Haxhimustafa –është dashur të meret mendimi pak më i thuktë nga profesionalistët, po si do që të jetë investitori së bashku me operatorin do ti shohin ato gjërat. Po mos po na del nesër se aty janë 12 banesa ndoshta dalin 15, 15 familje të cilët krijojnë ujra të zeza, fundi i asaj banese janë shtëpitë dhe oborret të cilët jetojnë, kah do ta qojmë atë kanalizim, kah Brestovci apo deri në prru atje, ajo duhet të mendohet se nesër do të kihet problem?!

Kryetari –nuk është çështje e kuvendit me u debatua këtë. Natyrisht ne e dimë që secili objekt duhet me pas tash rrymë, kanalizim, ujë, atëherë nuk duhet me i dëmtua askënd. E ajo nuk është banesë kolektive, por do të jetë qendër e pritjes së të riadhesuarve. Është qendër e banimit të përkohshëm. Ky është titulli i këtij projekti: Qendër pritëse e të riadhesuarve dhe natyrisht objekti duhet me pas kanalizim, ujësjellës, rrymë, mos me i dëmtua të tjerët, etj. Unë ju ftoj që të votoni dhe mos të humbim kohë.

Kryesuesi –kush është për aprovimin e kësaj? Unanimisht aprovohet.

9. Plotësimi i Komitetit për Komunitete me anëtar nga komuniteti pakicë.

Në muajin mars të vitit 2010, ku kemi formua KPF kemi zgjedhur 3 anëtar për komitetin për komunitete nga ana e kuvendit, mirëpo ka mbetur edhe pjesa tjetër pa u plotësuar nga anëtarët e komunitetit pakicë. Nuk kemi arritur, d.m.th kryetari i komunës të gjejë njerëz që të angazhohen në këtë komitet, tani e ka pru një listë me disa emra, është e drejt e kuvendit që të vendos që ta formojmë këtë komitet, ta plotësoj listën në mënyrë që edhe ky komitet të jetë funksional i cili e ka vendin e veçantë si trup i komunës.

Kryetari - Anëtarët e Komitetit Komunal për Komunitete të propozuar, e të cilët do të punojnë bashkë me anëtarë e zgjedhur nga Kuvendi i komunës janë:

1. Miroslav Manitasheviç nga Hoça e Madhe,
2. Tatjana Kollashinac nga Rahovec-i, OJQ "Gruaja moderne" Rahovec.
3. Bujar Morina Ratkovc, përfaqësues i komunitetit RAE-a
4. Resmije Hamza ,Rahovec, përfaqësuese e komunitetit Ashkali.
5. Nenad Miliç, Hoçë e Madhe,
6. Miroslav Lluqiç, Hoçë e Madhe.

Është Komitet obligativ, Kuvendi e ka kryer punën e vetë kur i ka zgjedhur, qeveria s'ka mundur ta krijoj që nga shpallja e pavarësisë. Do të ishte mirë me u bë funksional, ne do të punojmë shumë me Hoçën e Madhe, do të punojmë shumë me lagjen e epërme do të punojmë me përfaqësuesit e komunitetit RAE-a, dhe do ti diskutojm natyrisht të gjitha gjërat të cilat lidhen edhe me interesat objektive të këtyre komuniteteve. Ju do të keni informata të mjaftueshme në kuvend ai do ti raportoj kuvendit të komunës, kështu që mendoj që është mirë me kalua kjo listë, më duket ka një konflikt interesi te Rukija sepse nuk mund të jetë edhe anëtare e KPF-së edhe e komitetit të komuniteteve. Ju ftoj të zgjidhet një përfaqësuese për komitetin për komunitete nga radhët e kuvendit në vend të Rukije Krasniqit. Nëse i ka takuar Aleancës merruni vesh ju si subjekte politike.

Rukije Krasniqi – meqenëse ka qenë anëtar i Aleancës duhet të zëvendësohet me anëtarë të aleancës, mendoj që duhet të jetë Elhami Zhuniqi ose përfaqësuese gjinore Ilirijana Gashi.

Fahim Fetoshi – për çështjen e zëvendësimit unë mendoj se ne si AAK duhet të marrim një qëndrim një ditë tjetër por me rëndësi është të miratojmë këtë listë dhe ta funksionalizojmë Komitetin, por para se me e votua unë e kam një pyetje për kryetarin e Komunës: a kanë pranuar të jenë pjesë e këtij komiteti dhe a e gëzojnë respektin që të konsiderohen si të përfaqësuar nga këto komunitete?

Kryetari –përgjigja është shumë e thjeshtë, ne nuk mund të garantojmë në supozimet e tyre po që se hyjnë në zgjedhje do ti marrin të gjitha votat në Hoçë të Madhe ose në lagje të epërme. Esenciale është që ata nuk guxojnë të jenë pjesë e strukturave paralele, në momentin që informohemi në atë moment i shkarkoj. Do të punojnë në interes të komunitetit, do të jenë në harmoni me statutin komunës me LVL dhe kanë me i dhënë përgjegjësi dhe informacione këtij kuvendi. Secilit prej tyre ju ka bërë të qartë që nuk kanë punë as me Graçanicën, as me Deçanin, as me Mitrovicën e aq më pak me Beogradin, kaç.

Rasim Fazliu – Unë mendoj që kryetari është dashur që ti siguroj ata njerëz këtu që të jenë prezent këtu me qëllim që të deklarohen a janë të pajtimit apo jo.

Kryetari - Mbledhjen e parë të Komitetit për komunitete do ta mbajmë shumë shpejt sepse ata shpërblehen sikur anëtarët e KPF-së. Prandaj Rukija në këtë rast duhet të zëvendësohet sa ma shpejtë.

Feim Fetoshi – Unë i lus anëtarët e kuvendit që këtë çështje të mos e trajtojnë sot, unë po ju premtoj në mbledhjen e ardhshme do ta bëmë ndonjë propozim ëtu sepse kjo duhet të kalojë në konsulta të organeve të partisë.

Kryesuesi – Atëhere kush është për aprovimin e kësaj liste me anëtar të komitetit për komunitete? Faleminderit, a ka kundër? Nuk ka, a ka abstenim? Nuk ka. Faleminderit.

10.Shqyrtimi i kërkesës së familjes Lushi për ndarjen e mjeteve për shërimin e Alketa Lushit jashtë vendit në Itali. Unë posedoj dokumente për fletë lëshimin nga klinika universitare në Prishtinë ku faktikisht vajza në fjalë vuan nga zemra. Feimi qysh në fillim e paraqiti më detalisht gjendjen e kësaj vajze. Ajo ka një ofertë nga qyteti i Milanos e pasi që në Kosovë nuk ka mundësi me u shërua me shumë sa kushton ky operacion rreth 20 mijë euro. Nga ne kërkohet një shumë e konsiderueshme sa kemi mundësi ne si Kuvend i komunës ti ndihmojmë.

Fehim Fetoshi –bëhet fjalë për Alketa Vehbi Lushin, ende nuk është 7 vjeç, nga raporte shihet se vuan nga sëmundje shumë e rëndë. Alketa para disa muajve e ka humbur vëllanë edhe ai ishte i ri, , para pak viteve e ka humbur të atin, poashtu babai i saj para disa viteve i ka humbur dy vëllezërit dhe prindërit, të gjithë këta kanë vdekur nga një sëmundje që e përshkruajnë mjekët si sëmundje trashëguese. Mendoj që kemi të bëjmë me një rast tejet të rëndë dhe është mirë që ky kuvend komunal t'ia jep një shans për shërim, është këtu pra një para llogari që duhet këtu 20 mijë euro. Unë e kuptoj që qeveria komunale është e ngushtuar sa i përket mjeteve ndoshta nuk i ka paraparë por apeloj te ju këshilltarë komunalë që ta autorizojmë qeverinë komunale, e kemi këtë kompetencë si kuvend komunal, që të tërheqë mjete nga ndonjë kod tjetër e që Alketa të ndihmohet me së paku gjysmën e kësaj shume, Ndoshta do të jetë vendimi më i mirë, më humanë që do të bëjë ky kuvend prej se ka ekzistuar. Ju faleminderit shumë.

Nahit Elshani –edhe ne si grup i këshilltarëve të LDK-së e përkrahim këtë kërkesë, për shpëtimin e një jete të një fëmiu për shumë është mirë ti lihet kryetarit me qeverinë komunale të shikoj pasi që është fundi i vitit mundësit financiare që i kanë, sa ma shumë mundësi që kanë aq më mirë, dhe ne e përkrahim të gjithë.

Rasim Fazliu – Kjo është çështje solidarizimi, edhe grupi ynë e përkrah këtë iniciativë është me vend.

Sinan Ejupi – Edhe ne e përkrahim dhe i lëmë Qeverisë që të vendosë shumë e mjeteve.

Kryetari – po lëmë kështu që minimumi të jetë 5 mijë.Mbledhja ka përfunduar në ora 16,30.

K r y e s u e s i
Kujtim Popaj